



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 74 Akti

Nr. 69 Vendimi
Tiranë, më 10.10.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Firdes Shuli
Roland Ilia
Etleda Çiftja

Kryesuese
Anëtare
Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, më datë 8 tetor 2018, ora 10:30, në katin e dytë, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me adresë: Rruga Kavajës, ish Godina e “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Entela V. Prifti, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimi.**

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni D, Ç dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Prifti, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I.

1. Znj. Entela V. Prifti, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare, kryetare e Gjykatës së Apelit Korçë. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar si “ligji nr. 84/2016”), specifikon se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë; të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”.*

2. Në bazë të pikës 4, neni 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Entela Prifti i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar, më datë 15 janar 2018, me trupin gjykues nr. 4, të përbërë nga:

Roland Ilia	Komisioner
Firdes Shuli	Komisionere
Etleda Çiftja	Relatore

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “**ILDKPKI**”), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “**DSIK**”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “**IKLD**”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues nr. 4, i shortuar më datë 15.01.2018, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “**Komisioni**”), me vendimin nr. 01, datë 24.01.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuese të trupës, znj. Firdes Shuli; të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Më datë 13.09.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 02 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Prifti, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit

të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Më datë 13.09.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupës gjykuese.

7. Në po të njëjtën datë, më 13.09.2018, subjekti rivlerësimit bëri kërkesë për njohje me dosjen dhe marrja a një kopje të dokumenteve të dosjes, kërkesë e cila ju pranua po të njëjtën ditë me anë të postës elektronike.

8. Më datë 27.09.2018, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, solli shpjegimet e saj së bashku me provat. Komisioni administroi provat dhe shpjegimet e subjektit që u dërguan me anë të postës elektronike dhe në protokollin e institucionit.

9. Më datë 03.10.2018, me anë të vendimit nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Prifti, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 08.10.2018, ora 10:30 paradite, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me adresë: Rruga e Kavajës, ish Godina e "Lidhjes Shkrimtarëve dhe Artistëve", kati i 2-të, Tiranë.

10. Më datë 05.10.2018, subjekti i rivlerësimit kërkoi t'i viheshin në dispozicion raportet e vlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale. Komisioni, nuk e pranoi kërkesën, pasi provat e administruara nga ana e Komisionit për komponentin e pasurisë arritën nivelin e provueshmërisë për të kaluar barrën e provës dhe vendimi mund të merret bazuar vetëm në një komponent, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, i cili specifikon se: "*Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.*", si dhe sipas vendimit nr. 3, datë 17.07.2018, të Kolegjit të Apelit, pika 16, e seksionit III.1 të këtij vendimi.

11. Më datë 08.10.2018, ora 10:30, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit.

12. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: "*Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.*", trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Prifti, *vetëm* mbi komponentin e vlerësimit të pasurisë, duke mos vendosur mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

13. Për shmangien e çdo keqinterpretimi, ky vendim mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për znj. Entela Prifti merret vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kjo nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

II. SEANCA DËGJIMORE

Më datë 08.10.2018 u zhvillua seanca dëgjimore, në prezencë të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

Në seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë personalisht. Ajo parashtrroi shpjegimet e saj në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Seanca dëgjimore e datës 08.10.2018 u ndërpre, për të rifilluar më datë 10.10.2018, për shpalljen e vendimit. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent dhe depozitoi shpjegimet e saj me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nuk është konstatuar e njëjta gjë, për dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni për kërkesa specifike të cilat kanë mbetur në kuadër deklarativ.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

¹ Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashkohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Me shkresën nr. ***, datë 12.01.2018, të përbërë nga 48 fletë, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, e cila është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, më datë 30.01.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- a. *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b. *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c. *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d. *ka kryer deklarim të rremë;*
- e. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimi të pasurisë pranë ILDKPKI-së nga viti 2003 deri 2016 (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 27.09.2018, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

V/3. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit

1. Për deklarimin në lidhje me pasurinë, apartament banimi me sipërfaqe 55 m², ZK *, nr. pasurie ***, me adresë: Rr. “****”, Korçë. Pasuri bashkëshortore. Veprim juridik, kontratë shitblerjeje, nr. *** rep., *** kol., datë 18.9.2012. Ky informacion konfirmohet dhe nga ZVRPP-ja Korçë.**

Me burim krijimit :

- *Blerë me të ardhurat e babait të bashkëshortit në vlerën 1.600.000 lekë, paguar prej tij në marrëveshjen paraprake të shitjes me shitësen E.V. sipas deklaratës së nënshkruar mes palëve më datë 18.1.2012.*
- *Kursime familjare të subjektit të krijuara nga pagat, kredia e marrë në vitin 2011 dhe pagesat e qirasë së objektit të dhënë me kontratë qiraje, datë 05.03.2012, banesë ndodhur në “****”, në pronësi të bashkëshortit, subjektit “****” sh.p.k. Vlera 2.832.500 lekë. Pjesa takuese: 50 %.*

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

1.1. Me shkresat nr. *** prot., datë 30.01.2018, ZVRPP-ja Korçë, përcjell përgjigjet e ZVRPP-së Korçë ku konfirmohet pasuria e paluajtshme e regjistruar në emër të subjektit, e llojit, apartament, me sip. 55 m², ZK ***, nr. pasurie ***, vl. ***, fq. ***, e përfutuar me kontratë shitblerje, referenca nr. ***, ZK ***.

1.2. Drejtoria e Pastrimit dhe Parandalimit të Parave konfirmon se për shtetasin P.B.T. ka raportime të kontratave noteriale: Më datë 18.09.2012, ka blerë një apartament me çmim të deklaruar 2.832.500 lekë, nga pala shitëse, shtetase B.V., e datëlindjes 11.01.1944, E.V., e datëlindjes 05.06.1965 dhe M.V. e datëlindjes 03.07.1966.

1.3. ISSH-ja, drejtuar ILDKPKI-së, me shkresën nr. ***, datë 31.07.2017, nuk konfirmon periudha kontributive apo pension pleqërie prej vitit 2012 e në vijim për z. B. dhe znj. F.T.

1.4. DRT-ja Korçë, konfirmon se nuk ka të dhëna për të ardhurat nga punësimi deri më datë 31.12.2012, në emër të z. B.H.T. dhe znj. F.H.T., prindërit e b/shortit tuaj.

1.5. Më tej në kontratën e shitblerjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.09.2012, nuk citohet në asnjë vend aktmarrëveshja paraprake e shitjes, datë 18.01.2012, si dhe likuidimi i shumës 1.600.000 lekë, nga z. B.T.

Lidhur me burimin e ligjshëm financiar që ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti:

1.6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk konfirmon pension pleqërie për z. B. dhe znj. F.T., prej vitit 2012 e në vijim, pra nuk ka dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e të ndjerit B.T. në lidhje me pensionin.

1.7. Nga institucionet publike dhe private nuk konfirmohen të ardhura të tjera për personat në fjalë.

1.8. Në deklaratën “Vetting” deklarohet, pasuria, apartament banimi me sip. 55 m², ZK ***, nr. pasurie ***, Rr. “****”, Korçë. Pasuri bashkëshortore. Veprim juridik, kontratë shitblerjeje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.09.2012. Pjesa takuese: 50 %.

1.9. Shkresa me nr. *** prot., datë 30.01.2018, të ZVRPP-së Korçë, konfirmon këtë pasuri në emër të subjekti dhe b/shortit P.T.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

1.10. Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi një apartament banimi me sip. 55 m², Rr. “****”, Korçë. Fituar me anë të veprimit juridik, kontratë shitblerje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.09.2012.

1.11. Burimi i krijimit të blerjes së këtij apartamenti janë: (i) të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. B.T., në vlerën 1.600.000 lekë, paguar prej tij në marrëveshjen paraprake të shitjes me shitësen E.V. sipas deklaratës së nënshkruar mes palëve në datë 18.01.2012; (ii) kursimet familjare të subjektit të krijuara nga pagat; (iii) kredia e marrë në vitin 2011 dhe (iv) të ardhurat nga qiraja e objektit të dhënë me kontratë qiraje, datë 05.03.2012, objekti banesë, ndodhur në “****”, në pronësi të personit të lidhur me subjektin, z. P.T., subjektit “****” sh.p.k.

1.12. Nga hetimi kryesisht i Komisionit, u konstatua se:

- i.** Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacioni justifikues ligjor për dhuratën/kontributin financiar në vlerën prej 1.600.000 lekësh, nga personit tjetër të lidhur/z. B.T. si dhe nuk provohet me dokumentacion shkresor se si është bërë kalimi i kësaj shume nga z. B.T. te subjekti i rivlerësimit;
- ii.** Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të vërtetuar marrjen e shumës prej 1.800.000 lekësh nga personi tjetër i lidhur, për shitjen e kësaj banese në vitin 2002.
- iii.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pronësinë prej 50 % të këtij aseti nga personi i lidhur/bashkëshorti në deklaratën “Vetting”.

1.13. Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave dërguar, më datë 27.09.2018, si dhe deklarimet në seancën dëgjimore, shpjegoi se: Personi tjetër i lidhur/B.T. ka paguar me para në dorë *cash* një pjesë të vlerës së banesës në shumën prej 1.600.000 lekësh, bazuar në një marrëveshje paraprake shitjeje të pashkruar të datës 18.01.2012, midis personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, z. P.T., dhe personit tjetër të lidhur/B.T. dhe bashkëpronareve të apartamentit, përfaqësuar në këtë marrëveshje nga znj. E.V. Këtë shumë lekësh sipas subjektit të rivlerësimit, personi tjetër i lidhur/B.T. e ka pasur në posedimin e tij prej vitesh.

1.14. Kontrata përfundimtare e shitjes së banesës është nënshkruar midis personit të lidhur/z. P.T. dhe shitëseve E., B. e M. V., pasi personi tjetër i lidhur/z. B.T. ka ndërruar jetë në vitin 2012.

1.15. Me anë të kësaj kontrate është paguar pjesa e mbetur e pagesës nga të ardhurat familjare të realizuara ndër vite.

1.16. Znj. E.V. ka qenë përfaqësuese e pronarit, babait të saj S.V., që në momentet e para të ndërtimit të pallatit. Për këtë arsye dhe duke qenë një prej trashëgimtareve të pronarit ajo ka lidhur edhe kontratën paraprake të shitjes me personit të lidhur/bashkëshortin të subjektit dhe babain e tij, duke vepruar edhe në emër të bashkëpronareve të tjerë.

1.17. Regjistrimi në ZVRPP-në Korçë i pronës në emrin e bashkëshortit dhe subjektit ka ardhur për shkak të zbatimit të nenit 41 të ligjit nr. 33/2012, që përcakton regjistrimin e pasurive të paluajtshme, pronësia mbi të cilat është fituar gjatë martesës si dhe rregulloreve të ZVRPP-ve për regjistrimin e pronave bashkëshortore në emër të të dy bashkëshorteve.

1.18. Për sa i përket të drejtës së trashëgimisë ligjore të motrës së personit të lidhur/bashkëshortit, ajo banon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe nuk ka pasur

asnjë pretendim për ushtrimin e një të drejte të tillë edhe për faktin e qenies mirënjohëse ndaj personit të lidhur/bashkëshortit të personit të lidhur, për kujdesin ndaj prindërve, në kushtet kur ajo jeton larg Shqipërisë, që në vitin 1995, dhe nuk ka probleme financiare si edhe të faktit që ishte dëshira e babait të bashkëshortit për kalimin e pronësisë së kësaj banese te djali i tij, dëshirë e shprehur që në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes paraprake të shitjes, kur si palë blerëse kanë qenë bashkëshorti im dhe babai i tij.

1.19. **Në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 1.600.000 lekësh, nga babai i bashkëshortit B.T.**, subjekti shpjegon se këto të ardhura janë krijuar nga: (i) të ardhurat nga marrëdhëniet e punës së të dy prindërve të personit të lidhur/z. B.T.; (ii) të ardhura nga pensioni i pleqërisë; (iii) të ardhurat nga dhënia me qira e banesës së vajzës nga personi tjetër të lidhur, z. B.T., ndodhur në: Rr. “****”, pall. ***, shoqërisë “****”, me seli në Korçë, për t’u përdorur nga një prej ortakëve grekë të kësaj shoqërie; (iv) depozitimi i një sasive lekësh në bono thesari, pranë Bankës së Shqipërisë që nga viti 2002 dhe përfitimi i interesave përkatëse siç rezulton nga kartelat e klientit dhe nxjerrjet e llogarive që ju përkasin këtyre veprimeve të kryera; (v) kryerja e një aktiviteti të vogël, këmbimi valutor, nga ana e vjehrrit, duke shkëmbyer lekë dhe valuta të huaja në vlera të vogla sipas studimit të kurseve të këmbimit në treg; si dhe (vi) të ardhurat e realizuara nga shitja e banesës në pronësi së vajzës së personit tjetër të lidhur, në vitin 2002, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., në shumën 1.800.000 lekë.

1.20. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, (iv) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike; (v) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si dhe (vi) deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.20.1 Në lidhje me burimin e krijimit, dhurata në shumën prej 1.600.000 lekësh, bërë nga personi tjetër i lidhur/z. B.T., subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë pasi ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor nga personi tjetër i lidhur/babai i bashkëshortit, z. B.T., për shumën prej 1.600.000 lekësh, të bërë dhuratë subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtij apartamenti. Më tej subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues kalimin e kësaj shume të dhuruar nga personi tjetër i lidhur, vërtetuar sa më poshtë:

- i. Me shkresën, nr. *** prot., datë 30.01.2018, të ZVRPP-së Korçë, ku konfirmohet se pasuria e paluajtshme e regjistruar në emër të subjektit, e llojit apartament, me sip. 55m², ZK ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, e përfituar me kontratë shitblerje, referenca nr. *** ZK ***.
- ii. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë², konfirmon se nuk ka të dhëna për të ardhurat nga punësimi deri më datë 31.12.2012, në emër të personave të tjetër të lidhur/B.H.T. dhe F.H.T.
- iii. ISSH-ja, drejtuar ILDKPKI-së, me shkresën nr. ***, datë 31.07.2017, nuk konfirmon periudha kontributive apo pension pleqërie prej vitit 2012 e në vijim për z. B. dhe znj. F.T.
- iv. Më tej në kontratën e shitblerjes, nr. *** rep., *** kol., datë 18.09.2012, nuk citohet në asnjë vend aktmarrëveshja paraprake e shitjes, datë 18.1.2012, si dhe likuidimi i shumës 1.600.000 lekë, nga z. B.T., siç dhe subjekti i rivlerësimit deklaroi.

² me shkresën nr. ***, dt. 29.12.2017 (***, dt. 26.12.2017)

v. Drejtoria e Pastrimit dhe Parandalimit të Parave³ konfirmon se për shtetasin P.B.T., ka raportime të kontratave noteriale: Më datë 18.9.2012, ka blerë një apartament me çmim të deklaruar në vlerën 2.832.500 lekë, nga pala shitëse, shtetase B.V., e datëlindjes 11.01.1944, E.V. e datëlindjes 05.06.1965 dhe M.V., e datëlindjes 03.07.1966.

1.20.2 Sipas nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, personi tjetër i lidhur/z. B.T. , i cili ka konfirmuar marrëdhënien e dhurimit me subjektin e rivlerësimit, ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se personi tjetër i lidhur, shumë prej 1.600.000 lekësh, e ka siguruar nga shitja e shtëpisë së vajzës së tij që jetonte në SHBA. Nga kjo shitje ai ka marrë vlerën prej 1.800.000 lekësh, në vitin 2002, por pa provuar me dokumentacion ligjor provues marrjen e kësaj shume. Komisioni del në përfundimin se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të paguar/dhuruar shumë prej 1.600.000 lekësh, subjektit të rivlerësimit, shumë e cila ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti.

1.20.3 Për sa i përket deklarimit të subjektit se të ardhurat e babait të bashkëshortit janë krijuar nga marrëdhëniet e punës në shtet të dy prindërve të bashkëshortit dhe të ardhurat nga pensioni që ato kanë përfituar, duke shtuar këtu dhe pensionin e veteranit, nuk qëndron. Nga provat e administruara nga ana e Komisionit nuk u provua se personi tjetër i lidhur z. B.T. të kishte të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të justifikuar burimin e krijimit të shumë së paguar për këtë apartament.

1.20.4 Referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, pika 5 “ *Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 ...*”, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë të dhënat e detyrueshme për deklarim sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së subjektit. Ky deklarim bëhet edhe në raste kur personi i lidhur është subjekt deklarimi për shkak të funksionit pranë ILDKPKI-së, por që nuk është subjekt rivlerësimit.

1.20.5 Në lidhje me këtë apartament, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, rezulton pronar me 50 % pjesë takuese sipas dokumentit të administruar nga ZVRPP-ja Korçë, por që nuk e ka deklaruar këtë pronë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017. Komisioni del në përfundimin se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka fshehur pronësinë e 50 % të pjesës takuese të këtij apartamenti në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

1.20.6 Referuar dokumentacionit të administruar nga bankat rezulton se, personi i lidhur/bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit ka pasur një llogari rrjedhëse në USD, datë 01.06.2002, duke depozituar *cash* vlerën 12.045 USD, në “National Bank of Greece” (NBG) dhe më datë 07.06.2002, ka bërë transfertë në llogarinë e kredisë personale në Detroit Michigan, SHBA. Për këtë kredi nuk është raportuar dhe nuk kemi informacion nëse është mbyllur apo jo dhe sa ka qenë vlera e kredisë. Komisioni, duke përdorur arsyetimin kohor, logjik dhe aritmetik të kësaj shume në raport me faktet e tjera të dala nga hetimi, del në konkluzionin se kjo shumë e transferuar në SHBA, përputhet në fakt me shumë prej 1.800.000 lekësh të shitjes së apartamentit të motrës së z. P.T., në vitin 2002. Komisioni bazuar në këtë arsyetim, arrin në përfundimin se kjo shumë pas shitjes së apartamentit, më datë 06.06.2002, është transferuar në SHBA, më datë 07.06.2002.

1.20.7 Si konkluzion, të sa më lart arsyetuar në lidhje me këtë apartament, Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- i. nuk arriti të provojë të kundërtën e faktit të konstatuar se ka fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pronësinë e këtij apartamenti;
- ii. ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, për shkak se ka mungesë të burimeve financiare shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues për blerjen e këtij apartamenti;
- iii. ka fshehur të pasurisë nga ana e personit të lidhur/bashkëshortit;
- iv. ka deklaram të rremë në lidhje me burimin që ka shërbyet për blerjen e këtij apartamenti.

2. Për të ardhurat e deklaruara nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me prindërit, në shumën prej 1.000.000 lekësh.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga kontratë shitje, nr. *** rep., nr. *** kol, datë 04.04.2005, për shitjen e apartamentit të banimit me sip. 70 m², me palë shitëse, V., A. dhe Entela Prifti, në shumën 1.950.000 lekë. Bashkëlidhur certifikatë pronësie, datë 07.03.2005, dhe kartela e pasurisë në emër të V., A. dhe Entela Prifti.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

2.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017, në të cilën subjekti i rivlerësimit deklaroi se burim i të ardhurave të subjektit ndër të tjera janë dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me prindërit, në shumën prej 1.000.000 lekësh, pjesë takuese sipas bashkëpronësisë;

2.2 ZVRPP-ja Korçë konfirmon se, znj. Entela Prifti, ka figuruar b/pronare në pasurinë, nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, lloji apartament, me sip. 70 m², e cila aktualisht rezulton e tjetërsuar në favor të z. E.Ç. B/lidhur kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.04.2005, për shitjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe 70 m², me palë shitëse V., A. dhe Entela Prifti në shumën 1.950.000 lekë.

2.3 Në deklaramin vjetor të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shitja e këtij apartamenti është në vlerën 3.100.000 lekë.

2.4 Sipas kontratës, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.04.2005, për shitjen e apartamentit të banimit me sip. 70 m², me palë shitëse V., A. dhe Entela Prifti, të paraqitur në deklaramin “Vetting”, vlera është 1.950.000 lekë (që d.m.th pjesa takuese për subjektin është 650.000 lekë , 1/3 e pjesës takuese).

2.5 **Komisioni i dërgoi subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht në lidhje me këto të ardhura, për sa më poshtë i rezultonte:** *Ka mospërputhje deklarimesh për vlerën e shitjes së kontratës së apartamentit, me sip. 70 m², midis deklarams “Vetting” të vitit 2017, deklarams periodike vjetore të vitit 2015 dhe kontratës së shitjes së pronës, si burim i të ardhurave tuaja.*

2.6 **Ndërsa subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave dërguar, më datë 27.09.2018, si dhe deklaramet në seancën dëgjimore, shpjegoi se:**

2.7 Diferenca e shumës së shitjes deklaruar në vitin 2005 prej 3.100.000 lekësh, në shumën 1.950.000 lekë, në kontratën e shitjes, përfaqëson shitjen e sendeve të luajtshme të banesës nga prindërit e subjektit tek persona të tretë. Shitjet janë kryer prej prindërve me marrëveshje verbale ose fatura të thjeshta dore të cilat nuk mund t'i disponojnë aktualisht.

2.8 Për sa i përket mospërputhjes së vlerave të pasqyruara në deklarama sqaroj se në vitin 2003 ka filluar për here të parë deklarami i pasurive si proces verifikimi, bazuar në ligjin nr.

9049, datë 10.04.2003, dhe veç ligjit nuk na është komunikuar asnjë udhëzim apo mënyrë e plotësimit të deklaratës.

2.9 Në lidhje me mospërputhjen e vlerës së shitjes e apartamentit të banimit me sip. 70 m², më datë 04.04.2005, me palë shitëse V., A. dhe Entela Prifti, të paraqitur në deklarinim “Vetting”, subjekti deklaroi dhe e pohoi se ka mospërputhje të vlerës por kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së udhëzimit apo mënyrë të plotësimit të deklaratës nga vetë ILDKPKI-ja

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm.

2.10 Referuar nenit 32, pika , të ligjit nr. 84/2016, “*subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaramëve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë për të provuar diferencën në shumën prej 1.150.000 lekësh të çmimit të shitjes sipas kontratës së shitjes (është në shumën 1.950.000 lekë) me çmimin e deklaruar në deklaratën “Vetting” (3.100.000 lekë). Për rrjedhojë të ardhurat e deklaruara në shumën 1.000.000 lekë nga kjo pasuri, nuk janë të sakta pasi në fakt subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga kjo shitje shumën prej 650.000 lekësh, referuar çmimit të kontratës së shitjes.

2.11 Subjekti i rivlerësimit shpjegon, se kjo diferencë përfaqëson shitjen e sendeve të luajtshme të banesës nga prindërit e subjektit të persona të tretë. Shitjet janë kryer prej prindërve me marrëveshje verbale ose fatura të thjeshta dore të cilat nuk mund t'i disponojnë aktualisht, pranon se ka një diferencë.

2.12 **Subjekti rivlerësimit ka bërë deklarinim të rremë**, për shkak se në deklaratën “Vetting”, deklaroi se të ardhurat nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me prindërit, janë në shumën prej 1.000.000 lekësh, ndërsa shitja e apartamentit në bashkëpronësi me prindërit, në deklarinim “Periodik Vjetor 2005” është deklaruar në vlerën 3.100.000 lekë, ndërsa sipas kontratës nr. *** rep., *** kol., datë 04.04.2005, për shitjen e apartamentit të banimit me sip. 70 m², me palë shitëse V., A. dhe Entela Prifti, të paraqitur në deklarinim “Vetting”, vlera është 1.950.000 lekë. Kontratë shitje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.04.2005, për shitjen e apartamentit të banimit me sip. 70 m², me palë shitëse V., A. dhe Entela Prifti, në shumën prej 1.950.000 lekësh.

2.13 Si konkluzion të sa më lart arsyetuar në lidhje me këto të ardhura, Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- i. nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues diferencën në shumën 1.150.000 lekë, të çmimit të shitjes sipas kontratës së shitjes (është në shumën 1.950.000 lekë) me çmimin e deklaruar në deklaratën “Vetting” (3.100.000 lekë);
- ii. ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, për shkak se ka mungesë të burimeve financiare, në shumën prej 35.000 lekësh, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues për pjesën takuese përfituar nga shitja e apartamentit të prindërve;
- iii. ka deklarim të rremë në lidhje me shumën e shitjes së këtij apartamenti.

3. Të ardhurat nga shitja e automjeteve të mëposhtme:

Shitja e makinës, tip “Renault”, me kontratën e shitjes nr. * rep, datë 10.9.2004, në vlerën prej 450.000 lekësh ;**

Shitja e makinës, tip “Benz Daimlerchrysler”, blerë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, në vitin 2007, me kontratë shitblerje nr. * rep., nr. *** kol., datë 18.08.2007, prodhimi i vitit 2000, me vlerë 500.000 lekë, dhe mbas dy vjetësh në vitin 2009 me kontratën shitblerje, nr. *** rep., nr. *** kol., këtë automjet e shet në vlerën 6.000 euro.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

3.1 Kontratën e shitblerjes së automjetit, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.08.2007, me anë të të cilës subjekti ka blerë automjetin tip “Benz, viti i prodhimit 2001, me vlerë 500.000 lekë. Pas dy vjetësh në vitin 2009, subjekti deklaroi se këtë automjet e ka shitur në shumën 6.000 euro ose e barabartë me 823.020 lekë (konvertuar me kursin mesatar të vitit 2009 marrë nga BSH).

3.2 Kontratën e shitjes nr. *** rep., datë 10.9.2004, me anë të të cilës subjekti ka shitur automjetin tip, “Renault”, me targa ***, në vlerën prej 450.000 lekësh, dhe pse e kishit blerë atë në shumën prej 500 USD, dhe e kishit përdorur për rreth 2 vite e gjysmë.

3.3 Shkresa me nr. *** prot., datë 01.02.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, konfirmon se nuk ka automjet në pronësi në emër të subjektit Entela Prifti, dhe shtetasve P.T., E.T., E.M.T., V.P., A.P.

3.4 Konstatohet se të njëjtin fakt si më lart, mund të themi në lidhje me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.09.2004, subjekti ka shitur automjetin, tip “Renault”, me targa ***, në vlerën prej 450.000 lekësh, dhe pse e kishit blerë atë në shumën prej 500 USD-sh dhe të cilin e kishte përdorur për rreth 2 vite e gjysmë.

3.5 Komisioni i dërgoi subjektin të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht në lidhje me këto të ardhura, për sa më poshtë i rezultonte:

Çmimi i shitjes në kontratat e shitjes së automjeteve tip “Renault” dhe të “Benz” duket sikur nuk reflekton realitetin pasi sipas praktikës një makinë e cila është përdorur nga momenti i blerjes nuk i rritet vlera por amortizohet, dhe shitet më lirë ose sa çmimi i blerjes

3.6 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve të dërguara, më datë 27.09.2018, si dhe deklaratimet në seancën dëgjimore, shpjegoi se:

3.7 Për sa i përket diferencës midis çmimit të shitjes dhe blerjes së këtyre automjeteve, në të dy rastet subjekti i rivlerësimit i ka blerë makinat në gjendjen teknike jashtë përdorimi dhe më tej është punuar për riparimin e tyre nëpërmjet ndërrimit të pjesëve të prishura, kryerjes së riparimeve teknike dhe kthimin e tyre në gjendje pune nga babai i subjektit të rivlerësimit, meqë ai ka ushtruar për rreth 45 vjet profesionin e shoferit dhe mekanikut. Kjo shpjegon dhe diferencat midis çmimit të shitjes dhe atij të blerjes.

3.8 Sipas subjektit, fakt tjetër është se pavarësisht kohës së kaluar midis blerjes dhe shitjes së makinave, periudha e përdorimit të tyre prej saj ka qenë shumë e shkurtër dhe në këto rrethana amortizimi i tyre shumë i vogël.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm.

3.9 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion për të vërtetuar vërtetësinë e thënieve të saj në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe shpjegimeve përfundimtare në lidhje me diferencën midis çmimit të blerjes dhe atë të shitjes së të dy automjeteve. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor punimet e përmirësimit të gjendjes së

makina ve siç dhe subjekti i rivlerësimit pretendon të cilat kanë përmirësuar gjendjen e makinave dhe për rrjedhojë janë shitur më shtrenjtë respektivisht: shitja e makinë tip “Renault”, me kontratën e shitjes nr. *** rep., datë 10.09.2004, në vlerën prej 450.000 lekësh, dhe shitja e makinës tip, “Benz Daimlerchrysler”, me kontratën shitblerje me nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 6.000 euro.

3.10 Si konkluzion, Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në lidhje me çmimin e shitjes së këtyre automjeteve, për shkak se ka fshehur çmimin real të shitjes së këtyre automjeteve.

Deklarimet e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit

4. Apartament banimi duplex , me sipërfaqe 235 m², ZK * , me nr. pasurie *** , Rr. “***”, Korçë. Porositur apartamenti në fund të vitit 2001 dhe kryer pagesat në një periudhë kohore nga viti 2001 deri në vitin 2004.**

- i. kontrata e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., dhe nr. *** rep., *** kol., datë 15.04.2004. Blerë ndërtim i papërfunduar karabina. **Vlera 2.000.000 lekë.**
- ii. investim personal për përfundimin e rifiniturave me firmë tjetër ndërtimi, sipas situacionit të firmës “***”, në shumën 1.316.300 lekë dhe mobilim me blerje pajisjesh dhe mobiljesh për pjesën tjetër të vlerës. **Vlera 2.000.000 lekë.**

Burimi i Krijimit:

- i. me kursimet e të ardhurave nga paga në vite dhe
- ii. kredi bankare marrë nga “FEFAD” bank, e cila tashmë quhet “ProCredit Bank” në shumën 40.000 DEM (marka gjermane), me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.07.2001. Pas ndryshimit të monedhës, rimbursimi i kredisë ka vazhduar në monedhën euro. Me marrëveshje me bankë është shlyer kredia plotësisht në vitin 2003. Pjesët takuese:100 %.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

4.1 Shkresa me nr. *** prot., datë 30.01.2018, ZVRPP-ja Korçë, konfirmon këtë pasuri në emër të z. P.B.T.

4.2 Deklaratën “Vetting” 2017, ku subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti P.T., kanë deklaruar se kanë blerë një apartament banimi (3+1) me vlerë 4.000.000 lekë (2.000.000 + 2.000.000), me burim të ardhurash nga kredia e marrë në “ProCredit Bank”, në vitin 2001 dhe me kursimet personale duke filluar pagesat që nga viti 2001. Kontributi nga kredia është në shumën prej 2.445.934 lekësh (40.000 DM), ndërsa kontributi nga kursimet është respektivisht 1.554.065 lekë.

4.3 Subjekti deklaroi se investimi personal për përfundimin e rifiniturave është në vlerën 1.316.000 lekë, por ky investim nuk është shoqëruar me dokumentacion ligjor provues në lidhje me vlerën e shlyer prej 1.316.000 lekësh si dhe situacioni i punimeve nuk ka detajet e referencës për periudhën e kryerjes së punimeve.

4.4 Vlera e deklaruar për blerjen e pasurisë, apartament banimi duplex, me sipërfaqe 235 m² pasi, është deklaruar në total sipas kontratave të shitblerjes në shumën 2.000.000 lekë, ndërsa sipas kostove të ndërtimit dhe vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave në vite, nga EKB (<http://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit/>), rezultoi se kosto ndërtimi për vitin 2001 është

25.291 lekë, ndërsa kosto e shfrytëzimit 30.867 lekë dhe për vitin 2004, kosto ndërtimi është gjithsej 24.652lekë, ndërsa kosto e shfrytëzimit 28.840 lekë. Apartamentet janë deklaruar me sipërfaqe 235 m2 në total, në vlerën 2.000.000 lekë, ndërsa sipas EKB, vlera e tregut në vitin 2001 rezulton 7.253.745 lekë me kosto shfrytëzimi dhe 5.943.385 lekë me kosto ndërtimi.

4.5 Nuk është paraqitur dokumentacion justifikues ligjor/mandat pagese/konfermë bankare për likuidimin e shumës 1.630.300 lekë, ndaj firmës ndërtuese sipas situacionit të punimeve. Gjithashtu, situacioni i punimeve është i dyshimtë pasi nuk ka as datë dhe as periudhë kur është realizuar.

4.6 Konstatohet se kontratat paraprake për porositjen e apartamenteve në vitin 2001, nuk janë deklaruar në deklaratën e vitit 2003, para fillimit të detyrës.

4.7 Nga deklarimi i subjektit, konstatohet se pjesa takuese nga burimi i krijimit që i korrespondon të ardhurave nga paga është 1.554.065 lekë. Nga analizimi i dokumentacioni të administruar rezulton se në këtë periudhë, të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit nuk janë të mjaftueshme për të kontribuar me këtë shumë në blerjen e këtij apartamenti *dublex*.

4.8 Më tej, për të analizuar nëse subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme, Komisioni, kreu një analizë financiare për vitet 2001 - 2004, duke marrë në konsideratë:

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm.

Në lidhje me vërtetësinë e deklarimeve

4.9 **Në Deklaratën e Pasurisë, Vetting, të vitit 2017**, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj , z. P.T., kanë deklaruar se kanë blerë një apartament banimi (3+1) me vlerë 4.000.000 lekë(2.000.000 + 2.000.000), me burim të ardhurash nga kredia e marrë në “ProCredit Bank” në vitin 2001 dhe me kursimet personale duke filluar pagesat që nga viti 2001. Kontributi nga kredia është në shumën prej 2.445.934 lekësh (40.000 DM) ndërsa kontributi nga kursimet është respektivisht në shumën 1.554.065 lekë.

4.10 Komisioni hetoi, nëse subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, kanë paraqitur të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtij apartamenti *dublex*, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 1 të ligjit nr. 84/2016.

4.11 **Nga hetimi u konstatua se** subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar këto apartamente veç e veç në Deklaratën e Interesave Privatë “deklarimi për herë të parë në vitin 2003”, duke pasur parasysh faktin se personi i lidhur ka nënshkruar kontratën paraprake të shitjes në vitin 2001 dhe me nënshkrimin e kontratës ka filluar shlyerjen e detyrimeve sipas kontratës. Më tej, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk kishte bashkëlidhur kontratën e porosisë të vitit 2001 për të vërtetuar deklarinimin e tij se e ka porositur në vitin 2001, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, kontratat e shitblerjes së këtyre apartamenteve ishin me individ dhe jo me shoqërinë ndërtimit siç deklaronte subjekti. Më tej subjekti dhe personi i lidhur nuk vërtetonin me dokumentacion faktin që apartamentet ishin karabina dhe nuk i referoheshin kontratave të porosisë të vitit 2001, përfshirë këtu dhe pagesat prej vitit 2001.

4.12 Subjekti i rivlerësimit provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me mungesën e kontratës së porosisë së vitit 2001, për shkak se ajo dërgoi si provë kontratën paraprake shitblerje (dhe jo kontratë porosie siç deklaronte subjekti) me nr. *** rep ., nr. *** kol., datë 20.06.2001, para noteres F.B., e cila u mor në konsideratë nga ana e Komisionit.

4.13 Në lidhje me konstatimin se ky investim dhe porosi e këtij dubleksi nuk ishin deklaruar në deklarinim për herë të parë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se nuk e kishte deklaruar këtë porosi dhe investim në vitin 2003, pasi bashkëshorti i saj akoma nuk e kishte fituar të drejtën e pronësisë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049, datë 31.05.2003 dhe përcaktimet e Kodit Civil mbi të drejtën e pronësisë dhe momentin e fitimit të saj. Më tej ajo shpjegoi se fitimin e pronësisë e ka deklaruar në vitin 2004, vit kur dhe është nënshkruar kontrata e shitjes së pasurisë.

4.14 Komisioni në lidhje me këtë konstatim arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm në lidhje me porosinë dhe pagimin e kësteve të dubleksit për vitin 2003, duke e fshehur dhe mos deklaruar porosinë për dy apartamentet veç e veç dhe pagesat respektive, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049, datë 31.05.2003, “Për deklarinim dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë” , i ndryshuar, vërtetuar kjo me anë të deklaratës së vitit 2003 depozituar pranë ILDKPKI-së dhe kontratës së shitjes paraprake nr. *** rep., *** kol., datë 20.06.2001.

4.15 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se e ka blerë këtë apartament banimi duplex me anë të kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., dhe nr. *** rep., *** kol., datë 15.04.2004, në vlerën 2.000.000 lekë, të papërfunduar, karabina dhe ka bërë një investim personal për përfundimin e rifiniturave me firmë tjetër ndërtimi, sipas situacionit të firmës “****”, në shumën prej 1.316.300 lekësh dhe mobilim me blerje pajisjesh dhe mobiljesh për pjesën tjetër të vlerës. Vlera 2.000.000 lekë.

4.16 Nga hetimi administrativ Komisionit i rezultoi se: (i) për investimin e kryer për përfundimin e rifiniturave në vlerën 1.316.000 lekë situacioni i punimeve nga firma “****” nuk ka as datën dhe as periudhën kur janë realizuar punimet si dhe mungon dokumentacioni justifikues ligjor/mandat pagese/konfirmë bankare për likuidimin e shumës 1.630.300 lekë, pranë kësaj shoqërie; (ii) vlera e deklaruar për blerjen e pasurisë ‘apartament banimi duplex’ me sipërfaqe 235 m2 është deklaruar në total sipas kontratave të shitblerjes në shumën 2.000.000 lekë, ndërsa sipas kostove të ndërtimit dhe vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave në vite, nga EKB (<http://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit/>), rezulton se kosto ndërtimi për vitin 2001 është 25.291 lekë, ndërsa kosto e shfrytëzimit 30.867 lekë dhe për vitin 2004, kosto ndërtimi është 24.652 lekë, ndërsa kosto e shfrytëzimit 28.840 lekë. Apartamentet janë deklaruar me sip. 235 m2 në total, në vlerën 2.000.000 lekë, ndërsa sipas EKB, vlera e tregut në vitin 2001 rezulton 7.253.745 lekë me kosto shfrytëzimi dhe 5.943.385 lekë me kosto ndërtimi.

4.17 **Subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shpjegoi se** referuar kontratës paraprake të shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.06.2001, banesa është blerë nga shitësi si karabina, duke marrë përsipër blerësi, bashkëshorti i saj, kryerjen e punimeve të rifiniturës me shpenzimet e tij. Për këtë arsye është lidhur një marrëveshje gojore me firmën e ndërtimit “****”, me përfaqësuesen e saj ligjore L.K. dhe bashkëshortit P.T. në vitin 2003, sipas të cilës firma merrte përsipër punimet e rifiniturave për përfundimin e banesës kundrejt pagesës së shpenzimeve të kryera. Situacioni i punimeve të kryera, i paraqitur si provë edhe pranë ILDKPI-së është realizuar shlyerja e shumës prej 1.316.300 lekë, me para në dorë cash pranë zyrave të shoqërisë. Më tej, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se shoqëria e ndërtimit “****” ka pasur marrëveshje vetëm me bashkëshortin e saj për punimet e brendshme të banesës që kishim blerë dhe se kanë paguar të gjithë vlerën prej 2.000.000 lekësh që në fillimet e ndërtimit ndaj shitësit duke e ndihmuar atë edhe në momentet e para të investimit.

4.18 Në lidhje me krahasimin e vlerës së blerjes së apartamentit me vlerën e tregut për periudhën e kontraktuar, vlera prej 2.000.000 lekësh përfaqëson vetëm vlerën e karabinasë,

d.m.th volume betoni dhe mur tulle dhe jo vlerën e banesës së përfunduar. Në analizë të kostove të ndërtimit referuar edhe të dhënave të Entit të Banesave çmimet për njësi llogariten mbi bazën e ndërtimit të përfunduar ndërsa në rastin e blerjes së banesës në formën e karabinasë duke pasur parasysh se raporti midis ndërtimit karabina dhe rifinitura është gati 50 %, faktin se vlera e paguar prej nesh përfaqëson vlerën në kosto të ndërtimit, shuma prej 2.000.000 lekësh, është vlera reale e kësaj pasurie për gjendjen që ajo është blerë.

4.19 Bashkëlidhur me shpjegimet e mësipërme subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë një tabelë të llogaritjeve të volumeve të punimeve të karabinasë në këtë apartament, i vlerësuar me vlerat e përcaktuara në “Manualit 2012, VKM Nr. 407, datë 27.06.2012”. sipas subjektit, referuar kësaj tablele kostoja e karabinasë në vitin 2012 për ndërtimin e blerë prej tyre do të ishte 2.481.608 lekë, pas 11 vitesh nga momenti kur ata kanë blerë banesën.

4.20 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në lidhje me deklaramin se ka bërë investim personal për përfundimin e rifiniturave me firmën “***”, në shumën 1.316.300 lekë, për shkak se nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues punimet e kryera për përfundimin e rifinituarve nga firma “***”, si dhe nuk provoi me anë të një dokumenti ligjor provues pagesën që i ka kryer shoqërisë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur çmimin real të paguar për blerjen e apartamentit të banimit *dublex*, me sip. 235 m², të papërfunduar, karabina, në shumën prej 2.000.000 lekësh, për shkak se nuk arriti të provojë bindshëm me dokumentacion ligjor provues se kjo vlerë është vlera reale që personi i lidhur ka paguar krahasuar me koston mestare të ndërtimit sipas EKB-së, e cila është 5.943.385 lekë.

Në lidhje me burimin e krijimit

4.21 Në deklaratën “**Vetting**” të vitit 2017, personi i lidhur/bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit deklaroi se si burim krijimi kanë shërbyer:

- i. me kursimet e të ardhurave nga paga në vite dhe
- ii. kredi bankare marrë nga “FEFAD” bank, e cila tashmë quhet “ProCredit Bank”, në shumën 40.000 DEM (marka gjermane) me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.07.2001

4.22 **Nga hetimi kryesisht i Komisionit, konstatohet se pjesa takuese nga burimi i krijimit që i korespondon të ardhurave nga pagat ndër vite është në vlerën 1.554.065 lekë.** Për këtë qëllim u krye një analizë financiare, nga e cila u konstatua se të ardhurat nga paga e subjekti të rivlerësimit dhe bashkshortit të saj nuk ishin të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti *dublex*.

4.23 Më tej, për të analizuar nëse personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme, Komisioni kreu një analizë financiare për vitet 2001 - 2004 (vite kur është deklaruar pagesa), duke marrë në konsideratë:

- i. vërtetimet e pagës së subjektit dhe të bashkëshortit të saj, depozituar pranë ILDKPKI-së;
- ii. pasuritë e krijuara gjatë kësaj periudhe;
- iii. detyrimet ndaj të tretëve (sipas tabelës); dhe
- iv. shpenzimet për jetesë (*llogaritur sipas metodologjisë së ILDKPKI-së, e cila është shumë më e ulët se realiteti*)

4.24 Për më shumë, referuar gjendjes së likuiditeteve në bankë në fund të vitit 2004 rezultoi se në këtë vit situata financiare e personit të lidhur dhe subjektit të rivlerësimit është me rezultat

negativ në vlerën prej - 6 870 588 lekësh, për shkak se të ardhurat e realizuara në vitin 2004 janë të pamjaftueshme për :

- i. të blerë apartamentin që ju deklaroni;
- ii. për të blerë tokën arë në Voskopojë;
- iii. për të blerë 8 % të aksioneve në shoqërinë “****” sh. a;
- iv. për të krijuar likuiditete në bankë në shumën 4.832.690 lekë;
- v. për të kryer rikonstruksionin e banesës me qira, të “****”; dhe
- vi. për të bërë shpenzimet e nevojshme, minimale jetike.

4.25 Për më shumë referohu tabelës 1 - analiza financiare 2001 - 2004, si më poshtë:

Nr.	ANALIZA FINANCIARE	2001 - 2004
1	Të ardhurat	6 951 528
	Paga, shpërblim vjetor etj.	2 544 099
	Paga e bashkëshortit dhe shpërblim vjetor	3 427 930
	Të ardhura nga shitja e automjetit, tip “Renault”	450 000
	Dieta Entela dhe bashkëshorti (134 162+395 337)	529 499
1/1	Të ardhura për periudhën 1985 - 2000	0
	Entela 92 - 2000	0
	Bashkëshorti 85 - 2000	0
2	Pasuritë	15 665 357
	Apartament banimi <i>duplex</i> me sipërfaqe 235 m ²	4 000 000
	Shtuar gjendja e likuiditeteve në bankë	4 832 690
	Tokë arë sip. 3460 m ² (1/3 pjesë)	576 667
	Aksione në shoqërinë “****” sh. a., 8 % (6496 aksione)	6 256 000
3	Detyrimet	8 445 934
	Huamarrje A.B.	5,000,000
	Huamarrje V.P.	1,000,000
	Kredi në “ProCredit Bank” (20.047 euro x122.01 lekë/euro kursi BSH)	2 445 934
	Pasuria neto = pasuritë – detyrimet	7 219 423
4	Shpenzimet	5 922 444
	Paguar këst kredie të marrë në vitin 2001	1 420 000
	Shp. jetike sipas ILDKPKI-së (3 vite x 482143 +1 vit x 642 857)	2 089 286
	Transfertë e llogarisë e kredisë personale në Detroit, SH.B.A, shuma 12.945 USD (1.739.659 lekë), datë 07.06.2002	1.739.659
	Shpenzime për qira banese 2003 (vjetore)	144 000
	Shpenzime për udhëtime brenda vendit (Dietat)	529 499
	Investim në vitin 2000	
	Shpenzime jetike 1998 - 2000	
	Diferenca:	- 6 190 339

4.26 **Subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit** në lidhje me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare, vlerëson se kjo analizë është kryer në mënyrë të gabuar duke mos vlerësuar në mënyrë të qartë të ardhurat e realizuara, shpenzimet e kryera, kohën e këtyre shpenzimeve, periudhat kohore gjatë të cilave ajo dhe bashkëshorti i saj kanë realizuar të ardhura financiare, duke çuar Komisionin në një vlerësim të gabuar të situatës financiare të familjes së saj në rastin konkret. Bashkalidhur këtij shpjegimi subjekti i rivlerësimit dërgoi: (i) vërtetim nga UKKO-ja Korçë, datë 09.09.2018, për të vërtetuar të ardhurat e z. P.T. nga viti 1985 deri në vitin 2017; dhe (ii) vendime gjyqësore të marra nga, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, nga viti 1992, 1993, 1994, 1995.

4.27 Dokumentacioni i dërguar nga ana e subjekti të rivlerësimit u konsiderua nga ana e Komisionit për efekt të analizës financiare, por nuk hodhi poshtë rezultatin e hetimit për mungesën e burimeve të ligjshme financiare gjatë viteve 2001- 2004.

4.28 **Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat** e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie dhe ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie;
- ii. subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj nuk paraqitën dokumente që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtij apartamenti banimi *dublex*, investuar vlera 4.000.000 lekë, nga viti 2001 deri në vitin 2004, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 1 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë aset, për shkak se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar investimin në blerjen dhe ndërtimin e rifinituarve, në shumë 4.000.000 lekë, nga viti 2001 deri në vitin 2004.

5. Banesë me sipërfaqe 198 m², “**” ZK ***, nr. pasurie ***, ndodhur në, “****”, Korçë, nr. ***. Vlera 4.000.000 lekë. Pronësi është fituar me 2 veprime juridike. Konfirmohet me shkresën e ZVRPP-së Korçë.**

Burimi i krijimit:

- Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.06.2008, për fitimin e pronësisë mbi ½ pjesë e pronës.
- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.03.2009, për fitimin e pronësisë mbi ½ pjesë e pronës në vlerën 4.000.000 lekë me burim:
 - i. të ardhura të siguruara nga kalimi në llogarinë e bashkëshortit P.T., të shumës prej 1.920.000 lekësh, nga bonot e thesarit në emër të prindërve të tij B. e F.T., të kaluara dhe dhuruara nga babai B.T., në llogarinë e P.T.;
 - ii. të ardhura të realizuara nga shitja e një autoveturë, tip “Benz”, në shumën 6.000 euro, në pronësi të bashkëshortes Entela Prifti;
 - iii. kursime nga pagat e shpërblimet e realizuara në vite nga puna ime dhe e bashkëshortes sime.

Rikonstrukcioni i banesës është kryer në vitin 2011, në vlerën 6.979.400 lekë, me burim krijimi:

- i. kredi bankare marrë te “Credins Bank”, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.201, për shumën 70.000 euro

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

5.1 Shkresë me nr. *** prot., datë 30.01.2018, të ZVRPP-së Korçë, konfirmon pasuri në emër të z. P.B.T. nga ku konfirmohet pasuria e paluajtshme e regjistruar në emër të z. P.T., e llojit truall + ndërtesë, nga kjo 198 m² truall dhe 133.56 m² ndërtesë.

5.2 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017, ku personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit deklaroi se sipërfaqja e truallit është 198 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 133.56 m².

5.3 Pamjet filmike të emisionit “Agonland” dhe “Fiks Fare”, ku evidentohet se banesa është godinë me një kat përdhës - piceri; kati 1- lokal bar; kati 2 - restorant; kati 3- verandë – bar lokal, ndërsa sipas preventivit të punimeve të muajit shkurt 2012, të paraqitur nga subjekti për rikonstruksionin e godinës dhe kthimin në identitet të saj, rezultoi se në zërin nr. 21, shtresë dysHEMEJE, janë shtruar 390 m².

5.4 Shkresa, më datë 06.03.2018, ardhur nga notere K.T., Korçë, me anë të së cilës na vihet në dispozicion dokumentacioni dhe prokura e shtetases V.Z., me banim në USA, sipas shkresës sonë me nr. *** prot., datë 05.03.2018, dhe bashkangjitur prokura e posaçme në emër të A.K. e përkthyer në gjuhën shqipe.

5.5 Shkresa, më datë 19.03.2018, ardhur nga noter B.Z., i cili përcjell praktikën e plotë të kontratës së dhurimit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.09.2007, midis dhuruesve N.Z., J.Z., dhe pranuesit të dhurimit z. V.D., bashkangjitur prokura e posaçme në gjuhë të huaj nga noteri i huaj në USA, përkthyer nga përkthyes i licencuar.

5.6 Deklaratë me shkrim dore, datë 10.10.2000, paraqitur nga ana e subjekti të rivlerësimit, ku A.K., si administratore e katit të parë të pronës në “****”, deklaroi se një shpenzimet e z. P.T. në këtë banesë për rikonstruksionin e saj, për shkak të gjendjes së amortizuar dhe përshtatjes për banim dhe mobilimin e saj; njëkohësisht palët janë dakord dhe për pagesën mujore të qirasë në vlerën 10.000 lekë, për shfrytëzimin e banesës nga z. P.T. Lidhur me shpenzimet e këtyre punimeve, znj. A.K., deklaroi se do t'i shlyejë brenda 2 viteve nga data e nënshkrimit të kësaj deklarate dhe në rast se ky detyrim nuk kthehet brenda afatit të caktuar, z. P.T., do kompensohet me pronën e lartpërmendur dhe palët do të bisedojnë dhe zgjidhin në mënyrë miqësore dhe kompensime të tjera të mundshme për të cilat do të bien dakord me vullnetin tyre.

5.7 Në deklaratën e interesave private “Para Fillimit të Detyrës 2003”, personi i lidhur/bashkëshorti juaj ka deklaruar detyrim për qira vjetore në shumën 144.000 lekë (respektivisht shuma 12.000 lekë në muaj), por nuk deklaroi investim në rikonstruksion të kësaj banese.

5.8 Në deklaratën e interesave private “Para Fillimit të Detyrës 2003”, personi i lidhur/bashkëshorti juaj nuk ka deklaruar detyrime të pashlyera nga znj. A.K., si administratore, për shpenzime të kryera në këtë banesë lidhur me rikonstruksionin, përshtatjes për banim dhe mobilimin e saj, fakt që do të thotë se ose këto detyrime janë shlyer para vitit 2003, ose nuk kanë ekzistuar asnjëherë.

5.9 Sipas aktit të vlerësimit të po kësaj pasurie, për vlerën e tregut të lirë të saj, në periudhën korrik 2008, kohë kur është bërë dhurimi, vlera është përcaktuar 8.280.356 lekë dhe vlerë e tatueshme e ½ pjesë, ku dhurues është z. B.K. dhe pranues z. P.T. është 4.140.000 lekë;

5.10 Sipas çmimit/m² të përdorur nga vlerësuesi, banesa llogaritet të vlerësohet rreth 20.794.627 lekë në total (390 m²*48.800 lekë/m²=19.032.000 lekë + truall 1.762.627 lekë) dhe jo 8.280.000.356 lekë sa është në akt dhe që i përket sip. ndërtimit vetëm të 133.56 m².

5.11 Dhe sipas kësaj analize, ½ pjesë e pasurisë do të kushtonte në vitin 2008 rreth 10.397.313 lekë, ndërsa brenda 9 muajve (datë 19.03.2009) kur b/shorti juaj blen pjesën tjetër

të pasurisë, vlera e saj në kontratë është 4.000.000 lekë, dukshëm e ulët krahasuar me tregun për periudhën.

5.12 Likuidimi i situacionit të punimeve për rikonstruksionin e godinës dhe kthimin e saj në identitet për banesë, është paguar *cash*, me mandatarkëtim nr. ***, datë 16.02.2012, në shumën 6.979.400 lekë, nga z. P.T., te shoqëria “****” sh.p.k.

5.13 Shkresa me nr. *** prot., datë 15.03.2018, ardhur në Komision, nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., me anë të së cilës nuk japin asnjë dokumentacion dhe provë në lidhje me shumën e investimit të kryer në banesën e b/shortit të subjektit z. P.T., në “****”, Korçë. Argumentimi i tyre për këtë përgjigje ishte së ka qenë marrëveshje e lidhur ndërmjet palëve por e “pa shkruar” për rikonstruksionin e banesës si dhe në lidhje me situacionet dhe preventivat e punimeve, pretendojnë se nuk i disponojnë për arsye se janë vjedhur disa herë zyrat e shoqërisë.

5.14 Ndërsa sipas aktmarrëveshjes së datës 14.01.2013, (e cila nuk është para noterit) midis pronarit të banesës z. P.T. dhe administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., z. Z.Sh., thuhet se në vazhdim të marrëdhënies së tyre palët bien dakort që për periudhën prill - dhjetor 2013, objekti të mbahet në përdorim nga qiramarrësi Z.Sh., pa kundërshtim; qëllimi i përdorimit do të jetë përshtatja e kësaj banese në lokal shërbimi, i cili do të përdoret nga qiramarrësi në të ardhmen si i tillë, pa përcaktuar se sa janë shpenzimet e nevojshme që do të kryhen, apo janë kryer nga shoqëria “****” sh.p.k., për përshtatjen e kësaj banese në lokal shërbimi. Gjithashtu, nuk është paraqitur asnjë preventiv apo situacion punimesh, në të cilin të rezultojë se sa ka qenë vlera e investuar në përshtatjen e kësaj banese në lokal shërbimi.

5.15 Nga ana tjetër, sipas pamjeve fotografike dhe regjistrimit filmik nga “Agonland”, godina është e mirë arëduar në të katër katet e saj, me pajisje bashkëkohore dhe luksoze, dukshëm të kushtueshme për funksionimin normal të çdo ambienti të dedikuar sipas kateve dhe funksionaliteteve përkatëse; ndërsa kundërshtimi i shoqërisë “****” sh.p.k., për arëduimin dhe kthimin e ambienteve në lokale shërbimi, sipas aktmarrëveshjes, datë 14.01.2013, për periudhën prill - dhjetor 2013, llogaritet të jetë rreth 27.000 euro (3.000 euro ka qenë qira mujore*9 muaj).

5.16 Më datë 05.01.2014, z. P.T., si qiradhënës ka lidhur kontratë qiraje (e pa noterizuar) me shoqërinë “****” sh.p.k., si qiramarrës për ndërtesën ndodhur në Korçë, Bulevardi “****”, nr. ***, për dhënie me qira të objektit.

5.17 Ndërkohë, banesa është dhënë me qira tek qiramarrësi shoqëria “****” sh.p.k., me administrator z. Z.Sh., që në vitin 2012, dhe mbetet i panjohur fakti se sa kanë qenë shpenzimet për arëduimin e kësaj godine, deri në vitin 2012 kur është dhënë me qira për përdorim biznesi, me vlerën 3.000 euro/muaj, si dhe burimi i ligjshëm financiar për krijimin e tyre.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm.

a. Në lidhje me vërtetësinë e deklarimeve për sipërfaqen e banesës në pronësi

5.18 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti i saj deklaroi se ka në pronësi një banesë me sipërfaqe 198 m², “****”, nr. pasurie ***, ndodhur në Korçë, Bulevardi “****”, nr. ***, blerë në shumën 4.000.000 lekë. Kjo pronë është fituar me anë të kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.06.2008, për fitimin e pronësisë mbi ½ pjesë e pronës dhe kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.30.2009, për fitimin e pronësisë mbi ½ pjesë e pronës në vlerën 4.000.000 lekë. Më tej personi i lidhur me subjektin, deklaroi se në këtë banesë ka kryer rikonstruksion në vitin 2011, në vlerën 6.979.400 lekë.

5.19 **Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua se: (i)** Ka mospërputhje në lidhje me sipërfaqen e deklaruar të banesës, pasi në deklaratën “Vetting”, personi i lidhur deklaroi se ka një sip. 198 m² truall dhe 133.56 m² ndërtim, ndërsa sipas pamjeve fotografike si dhe ato filmike nga “Agon Channel” dhe “Fix Fare”, rezultoi se 133.56 m² është vetëm njëri kat, pasi ndërtesa përbëhet nga një kat përdhës - piceri; kati 1 - lokal bar; kati 2 - restorant; kati 3 - verandë - bar lokal, ndërsa sipas preventivit të punimeve dorëzuar nga ana e personit të lidhur, rezultoi se janë shtruar 390 m² dysheme;

5.20 “Agonland”, emisioni i realizuar nga ish-Agon Chanel TV, dëshmon me pamje filmike reale dhe përshkrime të detajuara, se banesa “****” (qiramarrësi) është godinë me një kat përdhës - piceri; kati 1 - lokal bar; kati 2 - restorant; kati 3 -verandë -bar lokal, ambiente të cilat janë dukshëm mirëfunksionale, të arregduara në mënyrë luksoze dhe rrjedhimisht me çmime tepër të konsiderueshme. Këto fakte provohen gjithashtu edhe pamjet fotografike të mundësuar nga rrjetet sociale.

5.21 Emisioni investigativ “Fiks Fare”, më datë 12.01.2016, denoncon pasurinë e subjektit dhe b/shortit të saj, si një vilë luksoze me 4 (katër) kate, bare, piceri, restorant, punimet e së cilës kanë zgjatur 4 vjet e gjysmë dhe me vlerë punimesh dhe arredimi, që shkojnë tejkalojnë ndjeshëm mundësitë dhe burimet e ligjshme financiare të subjektit dhe b/shortit të saj

5.22 **Kontatimet e mësipërme u vërtetuan me anë të:**

- i. Shkresë me nr. *** prot., datë 30.01.2018, nga ZVRPP-ja Korçë, e cila konfirmon pasuri të paluajtshme e regjistruar në emër të z. P.T., e llojit truall + ndërtesë, nga kjo 198 m² truall dhe 133.56 m² ndërtesë, e përfutur ½ me kontratë shitblerje dhe ½ me anë të dhurimit.
- ii. Situacionit të punimeve të muajit shkurt 2012, dërguar nga vetë subjekti i rivlerësimit, në vlerën 6.979.400 lekë, sipas të cilit në zërin nr. 21, shtresë dyshemeje, rezultojnë 390 m²; mandatarkëtim nr. ***, datë 16.02.2012.

5.23 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e saj përfundimtare dhe në seancë dëgjimore shpjegoi se** ishte i vërtetë fakti se godina në momentet që bashkëshorti i saj ka fituar pronësinë mbi këtë godinë ka qenë 2-katëshe me bodrum të papërdorshëm dhe papafingo me tarracë në katin fundit. Pas kryerjes së punimeve të rikonstruksionit të saj bodrumet janë pastruar dhe kthyer në ambiente të përdorshme, ndërsa godina në të dy katet e saj nuk ka pësuar ndryshime strukturore në kate apo muret e brendshme e të jashtme por vetëm rregullim i gjendjes së saj ekzistuese për shkak të dëmtimeve të mëdha nga vitet. Po kështu edhe çatia e saj.

5.24 Më tej subjekti shpjegon se pamjet e emisionit “Agon Chanel” dhe “Fiks Fare” pasqyrojnë realitetin e godinës ashtu si ajo është aktualisht për sa i përket funksionimit të saj si objekt me 1 kat bodrum, 2 kate ambiente të brendshme dhe tarracë e kthyer në ambient shërbimi e shndërruar si e tillë pas dhënies me qira të kësaj ndërtesë, qiramarrësit shoqërisë “****” sh.p.k.

5.25 Shtrimi i 390 m² dysheme përfaqëson shtrimin e dy kateve të saj dhe oborrit të jashtëm me pllaka dhe dysheme gjatë rikonstruksionit të saj në vitet 2010 - 2012.

5.26 **Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimit arrin në konkluzionin se** subjekti i rivlerësimit ka fshehur sipërfaqen reale të godinës në deklarimin “Vetting” të vitit 2017, duke mos e deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë e personit të lidhur me të. Me anë të shpjegimeve të saj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë dhe nuk e bindi Komisionin për të kundërtën e rezultateve të hetimit, por ajo i pranoi ato.

5.27 **Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës**, pika 1, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që

kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

5.28 **Më tej referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës**, pika 5, nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Në lidhje me dhurimin si mënyrë e fitimit të ½ pjesë të godinës:

5.29 **Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017**, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit deklaroi se: ½ (një e dyta) pjesë e kësaj pasurie i është dhuruar atij nga z. B.K. për shkak të marrëdhënieve familjare e miqësore, me të dhe familjen e tij. Shkak tjetër sipas personit të lidhur është dhe kompensimi për investimin e kryer në banesë për rikonstruksionin e saj, në vitet 2000 - 2001, periudhë gjatë së cilës personi i lidhur dhe familja e tij kanë jetuar në këtë banesë me kontratë qiraje deri në vitin 2004.

5.30 **Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua se** personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, nuk kishte paraqitur dokumentacion justifikues ligjor bindës për të provuar burimin e krijimit të kësaj pasurie nga z. B.K. (si dhurues) dhe se nuk kishte paraqitur dokumentacion provues ligjor në lidhje me masën e vlerës së investimit të kryer nga ana e tij për rikonstruksion gjatë viteve 2000 - 2001 në këtë banesë.

5.31 **Më tej u konstatua se**, personi i lidhur ka paraqitur një deklaratë me shkrim dore, të nënshkruar nga znj. A.K., si administratore e katit të parë të pronës në Bulevardin “****”, e cila deklaroi se një shpenzimet e personit të lidhur/z. P.T. në këtë banesë për rikonstruksionin e saj, për shkak të gjendjes së amortizuar dhe përshtatjes për banim dhe mobilimin e saj. Njëkohësisht palët kishin rënë dakord se pagesa mujore e qirasë do të ishte në vlerën 10.000 lekë, për shfrytëzimin e banesës nga personi i lidhur/z. P.T.

5.32 **Lidhur me shpenzimet e rikonstruksionit**, në të njëjtën deklaratë, znj. A.K., deklaroi se do t'i shlyejë brenda 2 viteve nga data e nënshkrimit të kësaj deklarate (10.10.2000) dhe në rast se ky detyrim nuk kthehet brenda afatit të caktuar, z. P.T., do kompensohet me pronën e lartpërmendur dhe palët do të bisedojnë dhe zgjidhin në mënyrë miqësore dhe kompensime të tjera të mundshme për të cilat do të bien dakord me vullnetin tyre.

5.33 **Përveç deklaratës nga znj. A.K.**, personi i lidhur nuk kishte paraqitur ndonjë dokument bashkëlidhur për të provuar shumën e investuar në rikonstruksionin e godinës ku jetonin me qira, me qëllim vërtetimin e shpenzimeve të kryera sipas kësaj deklarate.

5.34 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtarë dhe në seancë dëgjimore** dha shpjegime në lidhje me investimin e kryer në vitin 2000, duke shpjeguar se investimi në këtë pronë ka qenë kryesisht për përshtatjen e banesës së katit të parë të saj për banim, për shkak të gjendjes tejet të amortizuar të saj, duke investuar në rregullimin e saj.

5.35 **Vlera e këtij investimi ka qenë rreth 260.000 lekë**, aq sa banesa të ishte relativisht e banueshme dhe punimet janë kryer me skuadra punëtorësh sipas llojit të punës që kryhej. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe mënyrës së kryerjes së punimeve me grupe punëtorësh ose ustallarë private, **nuk ka dokumentacion shkresor që të provonin investimin e kryer**. Megjithatë nga ana e përfaqësueses së ish-pronarëve, e cila i ka parë dhe miratuar këto rregullime, provohet se ato kanë ekzistuar në momentin e hartimit të deklaratës së dorës, më datë 10.10.2000, të lëshuar nga shtetasja A.K.

5.36 **Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të ½ pjesë të pasurisë nga z. B.K.**, subjekti i rivlerësimit, nuk solli shpjegime apo prova të tjera nga ato që ka depozituar në deklaratën “Vetting”.

5.37 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe kontaktimet e dala nga hetimit arrin në konkluzionin se :

5.38 Personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. B.K., nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të ½ pjesë të dhuruar të pasurisë nga personi tjetër i lidhur duke mos paraqitur asnjë dokument i cili justifikon shkaku e dhurimit që i është bërë atij nga trashëgimtarët e familjes Z., sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016.

5.39 Pretendimet e personit të lidhur se shkak i dhurimit kanë qenë (i) miqësia familjare; (ii) investimi i kryer në banesë në kohën që personi i lidhur dhe familja e tij kanë jetuar me qira, deklaruar ky investim në shumë prej 260 000 lekësh; (iii) deklarata e bërë nga, znj. A.K., në vitin 2000, ku ajo deklaroi se do të njohë shpenzimet për rikonstruksion, si dhe palët bien dakort se nëse këto shpenzime nuk do të ktheheshin nga ana e znj. K., atëherë personit të lidhur do ti falej ½ pjesë e kësaj ndërtese, nuk qëndrojnë.

5.40 Si konkluzion në lidhje me dhurimin, Komisioni, arrin në përfundimin se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit/bashkshorti ka bërë deklaram të rremë në lidhje me dhurimin e ½ pjesë të kësaj ndërtese dhe ka nënshkruar një kontratë fiktive, për shkak se:

- i.** Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm me dokumentacion justifikues ligjor shkaku e ligjshëm që e ka shtyrë mikun e tij t'i bëjë këtë dhurim të ½ pjesë të kësaj godine, e cila rezultoi shumë fitimprurëse për personin e lidhur më tej;
- ii.** Personit tjetër i lidhur/z. B.K. nuk dërgoi dokumentacion ligjor provues për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të këtij dhurimi, sipas nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016;
- iii.** Investimi i kryer në vitin 2000 në këtë ndërtesë, në shumë prej 260 000 lekësh, nuk është në proporcion me vlerën e ½ pjesë të godinës dhe si e tillë nuk të jetë e barazvlefshme për kompensim(në rastin konkret dhurim);
- iv.** Deklarata e znj. A.K. nënshkruar për këtë qëllim, nuk ka elementët formal të një dokumenti shkresor dhe për më tepër, duke pasur parasysh rëndësinë e deklaramit ku palët bien dakort për dhurimin e ½ pjesë nëse nuk kthehej shuma prej 260.000 lekësh, kjo deklaramtë duhet të ishte nënshkruar para noterit publik me qëllim që të merrte formë e duhur;
- v.** Në deklaramtën e interesave private “Para Fillimit të Detyrës 2003”, personi i lidhur me subjektin nuk ka deklaruar detyrime të pashlyera nga A.K., si administratore, për shpenzime të kryera në këtë banesë lidhur me rikonstruksionin, përshtatjes për banim dhe mobilimin e saj, fakt që do të thotë se: ose këto detyrime janë shlyer para vitit 2003, ose nuk kanë ekzistuar asnjëherë dhe deklarata është e rreme.
- vi.** Gjithashtu, detyrimi i administratores për kryerjen e shpenzimeve nga qiramarrësi, bie ndesh me faktin e detyrimit të pagesës mujore për qira nga qiramarrësi, pasi normalisht, shpenzimet e investuara në përshtatjen e ambienteve të banimit nga qiramarrësi, ose zbriten nga vlera mujore e qirasë, ose nuk njihen nga qiradhënësi, pasi ato merren përsipër dhe kryhen në mënyrë të njëanshme nga qiramarrësi.

Në lidhje me blerjen si mënyrë e fitimit të ½ pjesë të godinës nga z. V.J.D.:

5.41 Në deklaramtën “Vetting”, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit deklaroi se ka lidhur një kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme, nr. *** rep., nr. *** kol, datë 19.03.2009, (shtëpi banimi), palë shitëse V.J.D. dhe blerës P.B.T., me sip. truall 198 m² nga e cila 133.56 m² ndërtesë me çmim 4.000.000 lekë. Në këtë kontratë të dy palët deklarojnë se likuidimi i vlerës është bërë me para *cash* (në dorë) jashtë zyrës noteriale.

5.42 Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit deklaroi se burimi i blerjes së ½ pjesë të kësaj banese, është nga: (i) të ardhura të siguruara nga kalimi në llogarinë e bashkëshortit P.T., të shumës prej 1.920.000 lekësh, nga bonot e thesarit në emër të prindërve të tij B. e F.T., të

kaluara dhe dhuruara nga babai B.T., në llogarinë e z. P.T.; (ii) të ardhura të realizuara nga shitja e një autoveture tip “Benz”, në shumën 6.000 euro, në pronësi të bashkëshortes Entela Prifti; (iii) kursime nga pagat e shpërblimet e realizuara në vite nga puna ime dhe e bashkëshortes sime.

5.43 Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk kishte paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të siguruara me anë të dhurimit nga prindërit e personit të lidhur B. e F.T. në shumën 1.920.000 lekë, shumë e cila është përfituar nga ato nëpërmjet bonove të thesarit. Pra, prindërit e personit të lidhur rezultonin me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të bërë këtë dhurim.

5.44 Më tej, nga hetimi u konstatua se të ardhurat në shumë 6.000 euro të përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga shitja e makinës, tip “Benz”, nuk përfaqësonin vlerën reale të shitjes dhe për këtë subjektin i kaloi barra e provës.

5.45 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore dha shpjegime në lidhje me konstatimet e Komisionit duke shpjeguar se të dy prindërit e bashkëshortit kanë qenë në marrëdhënie pune në shtet dhe kanë pasur të ardhura relativisht të larta referuar periudhës së punësimit.

5.46 Pas daljes në pension, ata kanë përfituar pension pleqërie dhe babai i bashkëshortit edhe pension veterani të luftës. Të dhënat e të ardhurave të realizuara ndër vite për aq sa dispononte ISSH-ja, dega Korçë, të nxjerra nga regjistrat e arkivit, për prindërit e bashkëshortit i ka bashkangjitur me deklaratën “Vetting” të dorëzuar pranë ILDKPI-së, ku vërtetohet pretendimi i mësipërm dhe po i paraqet edhe në këtë shpjegim për t’u konsideruar si provë.

5.47 Njekohësisht personi tjetër i lidhur, z. B.T., në periudhën që merrte pension pleqërie ka realizuar edhe të ardhura nga burime të tjerë si:

- i. Dhënia me qira e banesës së vajzës së tij ndodhur në, Rr. “***”, pall. ***, shoqëria “***” me seli në Korçë, për t’u përdorur nga një prej ortakeve grekë të kësaj shoqërie;
- ii. Depozitimi i një sasive lekësh në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë që nga viti 2002 dhe përfitimi i interesave përkatëse si rezulton nga kartelat e klientit dhe nxjerrjet e llogarive që ju përkasin këtyre veprimeve të kryera të cilat po i paraqes si provë para Komisionit. Shumat e depozituara përfaqësojnë kursimet në vite të prindërve të bashkëshortit dhe të ardhurat e vjela nga qiratë e banesës së vajzës së tyre;
- iii. Kryerja e një aktiviteti të vogël këmbimi valutë nga ana e babait të bashkëshortit, duke shkëmbyer lekë dhe valuta të huaja në vlera të vogla sipas studimit të kurseve të këmbimit në treg;
- iv. Të ardhurat e realizuara nga shitja e banesës në pronësi të motrës së bashkëshortit në vitin 2002 në shumën 1.800.000 lekë, të cilat i ka përfituar babai i bashkëshortit.
- v. Pas kryerjes së këtij veprimi juridik, shuma e lekëve të përfituara nga shitja me dëshirën e motrës së bashkëshortit dhe bashkëshortit të saj i është dhuruar prindërve të saj për ta përdorur për nevojat e tyre familjare. Kjo shumë është dorëzuar tek babai i bashkëshortit *cash* pa një akt të shkruar për shkak edhe të marrëdhënieve specifike babë-bir mes tyre.

5.48 Subjekti i rivlerësimit solli si provë për të provuar të ardhurat nga qeraja në banesën e vajzës së personit tjetër të lidhur, z. B.T., dokumentacionin ligjor të shoqërisë “***” sh.p.k., për të provuar aktivitetin e kësaj shoqërie në periudhën 1995 - 1999 dhe faktin që bashkë administratori grek A.S. ka banuar me qira në vitet respektivë në banesën e motrës së b/shortit të subjektit që jeton në SHBA.

5.49 Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi në lidhje me blerjen e ½ pjesë të banesës dhe arrin në konkluzionin se :

5.50 Referuar nenit D “Vlerësimi i Pasurisë”, pika 3, “*subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrime tatimore...*”.

5.51 Për të ardhurat e siguruara nga dhurimi me anë të kalimit në llogarinë e personit të lidhur me subjektin/P.T., të shumës prej 1.920.000 lekësh, nga prindërve e tij B. e F.T., subjekti i rivlerësimit, nuk arriti të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të investimit të bërë në bono në citin 2003 - 2004 dhe të të ardhurave nga ana e personave të tjerë të lidhur z. B. dhe F.T. të shumës 1.920.000 lekë që ka shërbyer si burim për blerjen e këtij aseti.

5.52 Pretendimet e subjekti të rivlerësimit në lidhje me burimet e krijimit nga persona të e tjetër të lidhur B. dhe F.T., nuk qëndrojnë pasi:

- i. marrëdhëniet e punës në shtet, relativisht të larta - por pa dërguar asnjë dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me këto të ardhura;
- ii. të ardhurat nga dhënia me qira e banesës së vajzës së tij - nuk vërtetoi as burimin dhe as ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja;
- iii. kryerja e një aktiviteti të vogël këmbimi valutator nga ana e personit tjetër të lidhur - subjekti nuk vërtetoi as burimin dhe as ligjshmërinë e të ardhurave nga puna si kambist;
- iv. të ardhurat e realizuara nga shitja e banesës në pronësi të vajzës së personit tjetër të lidhur - subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm se si të ardhurat e realizuara nga shitja e kësaj banese ishin të mjaftueshme për të blerës njëkohësisht $\frac{1}{2}$ pjesë të kësaj godine dhe të blerjes së apartamentit të banimit me sipërfaqe 55 m², ndodhur në, Rr, “****”, Korçë, sipas të deklarimeve të vetë subjektit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

5.53 Për të ardhurat të realizuara nga shitja e një autoveture, tip “Benz”, në shumën 6.000 euro, që ka shërbyer si burim tjetër i blerjes së $\frac{1}{2}$ pjesë të kësaj godine, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm se çmimi i shitjes së këtij automjeti ishte i vërtetë, për shkak se ky automjet është blerë me kontratë, nr. **** rep., nr. *** kol., datë 18.08.2007, në vlerën 500.000 lekë, dhe mbas dy vjetësh e dy muaj të përdorimit të tij, në nëntor të vitit 2009 është shitur për vlerën 6.000 euro.

5.54 Pretendimi i subjekti të rivlerësimit se pas blerjes së këtij automjeti, babai i saj, z. V.P., që ka ushtruar për rreth 45 vjet profesionin e shoferit dhe mekanikut, e ka riparuar atë nëpërmjet ndërrimit të pjesëve të prishura, kryerjes së riparimeve teknike dhe kthimin e tyre në gjendje pune, nuk qëndron për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk dërgoi dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me këtë pretendim.

5.55 Në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm që çmimi i shitjes ishte real/i vërtetë dhe për më shumë nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues riparimin e mjetit nga babai i saj.

5.56 Si konkluzion, Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të blerjes së $\frac{1}{2}$ pjesë të godinës, në shumë 4.000.000 lekë, si dhe rezultoi se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e blerë.

Lidhur me vlerësimin e çmimit të godinës për efekt të blerjes së $\frac{1}{2}$ pjesë nga z. V.J.D., në shumë 4.000.000 lekë

5.57 **Nga dokumentacioni bashkëlidhur deklarimit “Vetting” të vitit 2017 në lidhje me vlerësimin e çmimit të kësaj banese nga ZVRPP-ja Korçë dhe sipas aktit të vlerësimit të po kësaj pasurie, për vlerën e tregut të lirë të saj, në periudhën korrik 2008, vlera është përcaktuar**

8.280.356 lekë dhe vlerë e tatueshme e ½ pjesë, ku dhurues është z. B.K. dhe pranues z. P.T., është në vlerën 4.140.000 lekë. Në kartelën e pasurisë, kjo shumë rezulton si shumë e paguar.

5.58 **Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua se** sipas çmimit/m² të përdorur nga vlerësuesi, banesa llogaritet të vlerësohet në vlerën 20.794.627 lekë në total (390 m²*48.800 lekë/m²=19.032.000 lekë + truall 1.762.627 lekë) dhe jo 8.280.000.356 lekë sa është në akt dhe që i përket sip. ndërtimit vetëm të 133.56 m².

5.59 Sipas kësaj analize, ½ pjesë e pasurisë do të kushtonte në vitin 2008 rreth 10.397.313 lekë, ndërsa brenda 9 muajve (datë 19.03.2009) kur b/shorti i subjektit blen pjesën tjetër të pasurisë, vlera e saj në kontratë është 4.000.000 lekë, dukshëm e ulët krahasuar me tregun për periudhën.

5.60 Vlera e rivlerësuar e gjithë pasurisë në vitin 2012, sipas shënimeve përkatëse tek kartela e pasurisë është 30.000.000 lekë.

5.61 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se** në rastin konkret nuk mund të merren për referencë të dhënat e publikuara të Entit Kombëtar të Banesave për çmimet e ndërtimeve sipas qyteteve të ndryshëm, pasi nuk kemi të bëjmë me një banesë të re që po ndërtohet, por me një banesë të vjetër që është ndërtim i vitit 1930, e cila ishte në gjendje të degraduar dhe tejet e amortizuar. Sipas subjektit, kjo është arsyeja që banesa është vlerësuar me vlerën e përcaktuar dhe të referuara në kontratën e dhurimit dhe kontratën e shitjes së saj.

5.62 Subjekti gjithashtu ka kërkuar përgatitjen e një aktekspertimi të ekspertit J.S., i cili ka kryer vlerësimin e pasurisë për vitin 2008, të cilin e kërkoi të vlerësohej si provë nga Komisioni.

5.63 Për sa i përket analizës së vlerës së tregut, subjekti shpjegoi se pronësia mbi banesën është fituar nga personi i lidhur/bashkëshorti i saj para miratimit të projektit për rigjallërimin dhe sistemimin e Bulevardit “***”, në Korçë në vitin 2010, duke paraqitur si provë disa kontrata shitje apo dhurimi të pronave që ndodhen në Bulevardin “****” të tjetërsuara rreth viteve 2008 - 2010 të cilat kanë pasur strukturë ndërtimore të njëjtë me objektin në pronësi të bashkëshortit për shkak edhe të traditës ndërtimore të qytetit dhe që aktualisht funksionojnë si objekte shërbimesh apo banesa të rikonstruara, si kontratë dhurimi, datë 31.01.2008, kontratë dhurimi, datë 11.03.2008, kontratë shitblerje, datë 23.03.2007, kontratë shitblerje, datë 02.07.2009, kontratë shitblerje, datë 02.12.2008, 2 akte vlerësimi të pronave të ekspertëve të pavarur.

5.64 Subjekti më tej shpjegon se një rrethanë tjetër që ndikon në vlerën e shitjes së pronës është dhe situata e palëve pjesëmarrëse në kontratën e shitjes. Në rastin konkret ka qenë bashkëpronari tjetër i pronës, z. V.D., i cili për shkak të nevojës për mjete monetare në një moment të caktuar, i ka ofruar për shitje pjesën e tij prej ½ të banesës personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, duke respektuar të drejtën e parablerjes sipas kërkesave të ligjit.

5.65 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se:

5.66 Subjekti i rivlerësimit ka fshehur vlerën reale të blerjes së kësaj banese për shkak se gjatë hetimit u vërtetuar se vlera e tregut në vitin 2008 ka qenë rreth 10.397.313 lekë, ndërsa subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor se pse blerja ishte nën vlerën e çmimit të tregut.

5.67 Raporti i ekspertimit, i përgatitur nga ana e ekspertit J.S., është evaziv, i hartuar pa dokumentacion ligjor të plotë por vetëm nga supozimet, kërkesat e subjektit, nisur nga vetë deklaramet e ekspertit, citoj : *“Raporti i vlerësimit u përpilua, më datë 25.09.2018, për vlerën e ndërtesës në vitin 2008 kur është blerë dhe para rikonstruksionit të banesës. Nuk kam pasur*

akses në dokumentet origjinale të pronës. Nuk kam kryer asnjë investigim për të provuar vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga klienti, por i kemi marrë ato si të mirëqena. Për efekt të këtij vlerësimi është supozuar se të gjithë tituj legalë të pronës janë të plotë dhe të saktë. Është supozuar se informatat me shkrim dhe me gojë që na janë dhënë në emër të pronarit janë aktuale, të plota dhe të sakta në lidhje me pronësinë dhe çështje të tjera relevante siç është përcaktuar në raport”, për rrjedhojë akti i ekspertit ka realizuar dhe ka arritur në pretendimet e qëllimet e subjektit duke paraqitur një vlerë pasurie të përafërt me atë të dhënë më parë nga subjekti në deklaratimet periodike të pasurisë dhe në deklaratën “Vetting”.

5.68 Fakti që banesa ndodhet në një nga zonat më të preferuara në qytetin e Korçës, mbart vlera kulturore dhe është burim i konsiderueshëm të ardhurash, nuk justifikon çmimin e kontratës prej 4.000.000 lekësh të ½ pjesë të saj.

Në lidhje me vlerën e punimeve për rikonstruksionin e godinës dhe kthimin e saj në identitet

5.69 **Në deklaratën “Vetting”**, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit deklaroi se kjo godinë është rikonstruktuar në vitin 2011, sipas lejes së ndërtimit dhënë nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, datë 18.10.2010.

5.70 Shpenzimet për rikonstruksion janë përballuar me kredi bankare marrë tek “Credins Bank”, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2011, për shumën 70.000 euro, disbursuar nga banka në muajin dhjetor 2011.

5.71 Sipas situacionit të punimeve të kryera nga firma e ndërtimit “****” sh.p.k, vlera e rikonstruksionit të banesës dhe kthimi në identitet i saj ka qenë në shumën 6.979.400 lekë, sipas mandatit të arkëtimit bashkangjitur situacionit të punimeve.

5.72 Likuidimi i situacionit të punimeve për rikonstruksionin e godinës dhe kthimin e saj në identitet për banesë, është paguar cash, me mandatarkëtim nr. ***, datë 16.2.2012, në shumën 6.979.400 lekë, nga z. P.T. te shoqëria “****” sh.p.k.

5.73 **Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua se** likuidimi i situacionit të punimeve për rikonstruksionin e godinës dhe kthimin e saj në identitet për banesë, është paguar cash, me mandatarkëtim nr. ***, datë 16.2.2012, në shumën 6.979.400 lekë, nga z. P.T. tek shoqëria “****” sh.p.k.

5.74 Per të likuiduar këtë shumë , personi i lidhur ka marrë kredi në shumën 70.000 euro, pranë “Credins Bank”, me anë të kontratës bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2011. Ai ka tërhequr nga banka shumën prej 65.000 eurosh të kredisë për të shlyer detyrimin ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.

5.75 Pagesa është kryer me para në dorë cash edhe pse personi i lidhur ka marrë kredi dhe kishte mundësi të kryente shlyerjen e këtij detyrimi në shoqërinë “****” sh.p.k. me anë të një transaksioni bankar.

5.76 Komisioni, i kërkoi shoqërisë “****” sh.p.k. informacion në lidhje me këto pagesa dhe shoqëria u përgjigj se arkiva ishte vjedhur dhe nuk mbanin mend se sa para kishte paguar personi i lidhur/z. P.T. për rikonstruksionin e godinës.

5.77 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se** më marrëveshje të pashkruar personi i lidhur/P.T. dhe administratorja e shoqërisë “****”, kanë rënë dakord për kryerjen e punimeve ndërtimore për rikonstruksionin e banesës së ndodhur në Bulevard “****”.

5.78 Sipas subjektit, këto punime kanë përfunduar në fillim të vitit 2012 dhe pas përfundimit të tyre, është kryer edhe pagesa e vlerës së përcaktuar në situacion prej 6.979.400 lekësh. Pagesa është kryer në cash pranë zyrave të kompanisë të ndërtimit nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me mandatarkëtim, nr. ***, datë 16.02.2012, pasi kështu ka qenë edhe kërkesa e përfaqësuesve të firmës.

5.79 Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se :

5.80 Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të pamjaftueshëm pasi nuk arriti të provojë pagesën e kryer shoqërisë “***” për punimet e kryera në lidhje me rikonstruksionin e godinës private Bulevard “***”, në muajin shkurt 2012, në shumë 6.979.400 lekë. Për sa rezulton, nuk u provua shuma e paguar, lloji i punimeve si dhe koha e kryerjes së punimeve të rikonstruksionit.

5.81 **Në lidhje me vlerën dhe kohën e kryerjes së investimit**, subjekti pretendon se ka paguar 6.979.400 lekë pranë shoqërisë “***” sh.p.k. Ky pretendim nuk qëndron dhe Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi dhe provoi bindshëm se kjo ishte vlera e paguar për rikonstruksionin e godinës, duke fshehur investimin real për rikonstruksionin e kësaj godine për shkak se:

- i. Sipas udhëzimit nr.17, datë 13.05.2008, “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, pika 8.1.2 përcakton se : *“Kur shoqëritë e ndërtimit ndërtojnë për të shitur apo për të dhënë me qira, TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerë e situacionit mujor të punimeve. Bashkëlidhur me çdo situacion mujor duhet të jetë detyrimsht fatura tatimore me numër serial...”* . Referuar kësaj klauzole, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka paraqitur faturë tatimore me TVSH nga shoqëria “***” sh.p.k për punimet e kryera.
- ii. Situacioni i punimeve nuk është në formën që kërkon legjislacioni tatimor, pasi nuk përmban disa nga zërat e punimeve dhe gjithashtu nuk është pasqyruar vlera e tatimit mbi vlerën e shtuar prej 20 %.
- iii. Personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk provoi kryerjen e pagesës me në nga mënyrat ligjore si transaksion bankar, pasi ai deklaronte se ajo është kryer me lekë në dorë (me mandatarkëtim) dhe pse shuma ishte e konsiderueshme. Fakti që subjekti kishte marrë kredi bankare për të shlyer vlerën e rikonstruksionit, tregon se subjekti kishte mundësi reale për të bërë transferimin me bankë nga ai tek shoqëria e ndërtimit “***” sh.p.k, por ai qëllimisht nuk e ka kryer me anë të bankës, pasi donte që të fshihte vlerën reale të investuar për rikonstruksionin e godinës.
- iv. Nëse i referohemi situacionit të punimeve të kryera të paraqitur nga shoqëria “***”, del qartë se punimet janë kryer të gjitha në muajin shkurt 2012. Por po të analizojmë kohën që do duhet për të kryer këto punime, del qartë se nuk mundet që ato të kryhen brenda një muaji siç dhe vërtetohet nga situacioni i punimeve.
- v. Shoqëria ndërtuese “***” sh.p.k me anë të shkresës me nr. *** prot., datë 15.03.2018, dërguar Komisionit, nuk ka dërguar dokumentacion dhe provë në lidhje me shumën e investimit të kryer në banesën e b/shortit të subjektit P.T., të ndodhur në Bulevardin “***”, Korçë. Më tej shoqëria deklaronte se kjo marrëveshje për rikonstruksionin e kësaj godine ka qenë verbale e “*pa shkruar*” si dhe deklaronte se nuk i dispononin asnjë dokumente, për arsye se i janë vjedhur disa herë zyrat e shoqërisë.

Lidhur me shpenzimet për arredimin dhe kthimin e godinës në lokal shërbimi

5.82 **Në deklaratën “Vetting”**, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit deklaronte se në vitin 2012 banesa është dhënë me qira tek qiramarrësi shoqëria “***” sh.p.k me administrator

z. Z.Sh., kontratë e shkruar dhe nënshkruar nga palët sipas kërkesave të nenit 801 dhe 803 të Kodit Civil. Në përfundim të afatit të përcaktuar në kontratë me aktmarrëveshje, datë 14.01.2013, midis pronarit të banesës personit të lidhur/P.T. dhe administratorit të shoqërisë “***” sh.p.k., z. Z.Sh., është rënë dakord që nga qiramarrësi të kryhen punime të brendshme arredimi për kthimin e saj në lokal shërbimi.

5.83 Nga viti 2014 e në vazhdim, objekti funksionon si lokal shërbimi në administrim të shoqërisë “***” sh.p.k me administratore znj. V.Sh., bashkëshorte e z. Z.Sh.. Marrëdhënia është rregulluar me kontratë qiraje 1-vjeçare të rinovueshme me vullnetin e palëve sipas përcaktimeve të nenit 803 të Kodit Civil, kundrejt detyrimeve të marra përsipër nga secila palë

5.84 **Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua** se sipas aktmarrëveshjes së datës 14.01.2013, (e cila nuk është para noterit) midis pronarit të banesës z. P.T. dhe administratorit të shoqërisë “***” sh.p.k, z. Z.Sh., përcaktohet se në vazhdim të marrëdhënies së tyre palët bien dakord që për periudhën prill - dhjetor 2013, objekti të mbahet në përdorim nga qiramarrësi, z. Z.Sh., pa kundërshtim. Sipas së njëjtës aktmarrëveshje, qëllimi i përdorimit do të jetë përshtatja e kësaj banese në lokal shërbimi, i cili do të përdoret nga qiramarrësi në të ardhmen si i tillë, por pa përcaktuar se sa janë shpenzimet e nevojshme që do të kryhen, apo janë kryer nga shoqëria “***” sh.p.k, për përshtatjen e kësaj banese në lokal shërbimi.

5.85 Gjithashtu, u konstatua se nuk ka asnjë dokument që mund të vërtetojë se çfarë punimesh janë kryer dhe cila ka qenë vlera e investuar për këto punime. I vetmi citim në lidhje me vlerë e investuar për arredimin e godinës mund të nënkuptohet nga përcaktimet e akt marrëveshjes datë 14.01.2013, midis personit të lidhur/z. P.T. dhe z. Z.Sh. si administrator i shoqërisë “***” sh.p.k, ku përcaktohet se qiraja do të jetë pa kundërshtim për periudhën prill - dhjetor 2013. Duke marrë në konsideratë shumë e deklaruar të qirasë në vlerën prej 3000 eurosh në muaj dhe duke e shumëzuar me 9 muaj që është marrëveshja, rezulton se shuma totale është rreth 27.000 euro.

5.86 Nga ana tjetër, nga pamjet fotografike dhe regjistrimit filmik nga “Agonland”, godina është e mirë arreduar në të katër katet e saj, me pajisje bashkëkohore dhe luksoze, dukshëm të kushtueshme për funksionimin normal të çdo ambienti të dedikuar sipas kateve dhe funksionaliteteve përkatëse;

5.87 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se,** për sa i përket përshtatjes së godinës për ambient shërbimi nga firma “***” sh.p.k., subjekti “***” sh.p.k është një shoqëri tregtare e cila ka nënshkruar kontratën e qirasë me personin e lidhur/bashkëshortin e saj në vitin 2012 pas përfundimit të restaurimit të objektit banesë, duke përcaktuar në të edhe vlerën e qirasë dhe detyrimet e secilës palë.

5.88 Nga ana e personit të lidhur/bashkëshortit të saj nuk është kryer asnjë shpenzim arredimi pasi ai do të varej nga destinacioni për të cilin do të përdoret ndërtesa.

5.89 Më tej ajo thotë se, administratori i shoqërisë “***” sh.p.k., z. Z.Sh., i ka kërkuar personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit një marrëveshje të dytë për përdorimin e banesës si lokal shërbimi duke marrë përsipër prej tij kostot e punimeve për këtë përshtatje. Pas bisedimeve të kryera palët konkluduan në një marrëveshje sipas së cilës nga muaji prill 2012 deri në muajin dhjetor 2012 nga shoqëria “***” sh.p.k., do të kryheshin punime përshtatjeje që lidheshin kryesisht me pjesën arreduese të ambientit dhe dekorimin e tij bashkë me pajisjet e nevojshme për ushtrimin e një aktiviteti të tillë.

5.90 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se mes palëve nuk është biseduar për vlerat e investimit që do të kryhej dhe në asnjë deklaratë subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar se vlera e investimit për përshtatjen e banesës në lokal shërbimi është 27.000 euro. Shuma prej 27.000 eurosh është vlera e qirasë që do të përfitohet në rast se do të vazhdonte

kontrata e qirase e lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., por kjo rrethanë jo domosdoshmërisht duhet të përcaktojë edhe vlerën e investimit të kryer prej qiramarrësit.

5.91 Ndërsa për sa i përket referimit tek emisioni i “Agonland” në lidhje me përcaktimin e vlerës së shpenzimeve të kryera, subjekti shprehet se i duket jo e përshtatshme në rastin konkret dhe jo një burim i saktë informacioni, pasi ai ka qenë një emision marketingu i organizuar dhe porositur nga administratorja e shoqërisë “****” sh.p.k., njëkohësisht bashkëshorte e z. Z.Sh., për të reklamuar lokalitë në fillimet e aktivitetit të tij. Një emision i tillë i organizuar me qëllimin e berjes publik dhe reklamimit të biznesit nuk mund të merret për bazë për të përcaktuar llojin e investimit të kryer dhe përcaktimin e shpenzimeve të kryera - thotë subjekti.

5.92 **Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi arrin në konkluzionin se :**

5.93 Referuar nenit D, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.*

5.94 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe provojë vlerën e investuar për arredimin e godinës, pasi nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me këtë investim për kthimin nga shtëpi në njësi shërbimi, përfshirë kontrata sipërmarrje për punime ndërtimi, instalimi, furnizimi, etj.

5.95 Ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me kohën se kur është rënë dakord midis palëve në lidhje me ndryshimin e destinacionit nga banesë për banim në njësi shërbimi, duke ju referuar thëniet e subjekti dhe aktmarrëveshjeve të firmosura midis palëve.

5.96 Për sa më lart, Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë pasuri pasi ka bërë deklaram të rremë dhe ka fshehur vlerën e arredimit luksoz të godinës me një kat përdhes e përdorur si piceri, kati i parë përdorur si bar- kafe, kati i dytë i përdorur si restorant, kati i tretë i përdorur si verandë, e gjithë kjo me qëllim që të fshehë burimin e ligjshëm financiar për këtë investim.

Në lidhje me deklaramin e ambientit verandë

5.97 **Në deklaramin “Vetting”**, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk deklaroi se në katin e tretë të godinës, duke filluar nga kati përdhes, ka ndërtuar një verandë që e përdor si bar-kafe

5.98 **Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua** se subjekti i rivlerësimit nga viti 2012, ka ndërtuar një verandë e cila nuk ka qenë pjesë e strukturës ekzistuese të godinës së banimit. Kur janë kryer punimet për rikonstrukcionin dhe kthimin e godinës në njësi shërbimi, kati i tretë është përshtatur si verandë me qëllim që të përdoret për bar-kafe, në funksion të njësisë së shërbimit.

5.99 Më tej konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratat vjetore nga viti 2012 - 2016, por dhe në deklaramin “Vetting” të vitit 2017, verandën dhe qëllimin e përdorimit të saj.

5.100 Gjithashtu, nga pamjet e verandës - bar-lokal, duket se janë bërë ndërhyrje dhe ndryshime të ndryshme në strukturën e saj nga pamja fillestare, detaje nga të cilat krijohet bindja se është kryer ndërtim për kthimin e saj në lokal shërbimi, ndërtim i cili është fshehur nga subjekti në “Deklaramin e Pasurisë, Vetting”, dhe në deklaratat e interesave private “Periodike Vjetore”, prej vitit 2008 - 2016.

5.101 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi** se me fillimin e aktivitetit tregtar, Bar Restorant, nga

ana e shoqërisë “***” sh.p.k. për shkak edhe të ndalimeve të konsumimit të duhanit në ambiente të brendshme, u mendua prej qiramarrësit përshtatja e çatisë me një mbulesë provizore konstrukcion dru dhe qese për të mundësuar krijimin e një ambienti duhan pirës.

5.102 Për sa i përket mosdeklarimit në deklaratën vjetore dhe deklaratën “Vetting” të këtij ndryshimi, pra përshtatja e çatisë në verandë për qëllim përdorimi bar-kafe, subjekti shpjegon se kishte vlerësuar se ky ndërtim është provizor, ndërtimi provizor me zgjidhjen e kontratës së qirasë do të priset dhe objekti do të kthehet në gjendjen fillestare.

5.103 Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi arrin në konkluzionin se :

5.104 Referuar nenit D, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.*

5.105 Subjekti i rivlerësimit ka fshehur ndryshimin e destinacionit të çatisë , në verandë me qëllim përdorimin për bar-kafe , në deklaratën Vetting dhe në deklarimet vjetore, me qëllim që të fshehtë burimin e ligjshëm që ka shërbyer si investim për këtë ndryshim.

5.106 Vlerësimi i subjektit se ky ndërtim është provizor, ndërtimi provizor me zgjidhjen e kontratës së qirasë do të priset dhe objekti do të kthehet në gjendjen fillestare të , nuk qëndron, pasi sipas Nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur duhet të deklarojnë saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur, duke bashkëlidhur dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me brumin e krijimit të tyre.

5.107 Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklaram të rremë dhe kanë fshehur verandën e krijuar në çatinë e godinës dhe destinacionin e saj në deklarimin “Vetting” të vitit 2017 dhe deklarimet periodike vjetore.

6. Njësi me sipërfaqe 519 m², ZK *, nr. pasurie ***, ndodhur në Korçë, godina “****” në pronësi të bashkëshortit z. P.T. Veprimi juridik kontratë shkëmbimi aksionesh të shoqërisë “****” sh.a., nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.07.2012.⁴**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

6.1 ZVRPP-ja Korçë me shkresën nr. *** prot., datë 30.01.2018, konfirmon pasurinë e paluajtshme e regjistruar në emër të z. P.T., e llojit njësi, ZK ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, sip. 519 m², e përfituar me kontratë shkëmbimi. B/lidhur kontratë shkëmbimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.07.2012, për shkëmbimin e 8 % të aksioneve ose 9119 kontribute të zotëruara në shoqëri të z. P.T. me pasurinë e paluajtshme të llojit njësi, me sip. 519 m², ndodhur në katin e ***, të sesionit ***, të godinës “****” e zotëruar nga shoqëria “****” sh.a.

6.2 Shkresa me nr. *** prot., datë 28.03.2018, nr. *** prot., datë 03.04.2018, ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, në lidhje me të dhëna për xhiron dhe fitimin e deklaruar sipas viteve për shoqërinë “****” sh.a, gjithsej 135 fletë.

⁴ Me marrveshje të ortakut P.T. me shoqërinë dhe vendim të asamblesë së aksionerëve, u vendos që vlera e aksioneve të ortakut P.T. të kalonte tek shoqëria, duke u ndarë ato mes ortakëve të tjerë të saj dhe me shkëmbim ortakut P.T. do të fitonte pronësinë e njësisë prej sip. 519m2, të ndodhur në godinën *** në Korçë, në pronësi të shoqërisë. P.T. është aksioner i shoqërisë *** me krijimin e saj në vitin 2001 dhe ka zotëruar në masën 8% aksione të shoqërisë me vlerë 240.000 lekë.Në vitin 2003 është rritur kapitali i shoqërisë dhe vlera e aksioneve për pjesën prej 8% të ortakut P.T. është vlerësuar në masën 6.256.000 lekë, vlerë e cila është paguar nga ky ortak në llogaritë e shoqërisë.

6.3 QKB-ja , me shkresën nr. *** prot., datë 01.03.2018, konfirmon se shtetasi P.B.T. figuron të këtë qenë aksionar dhe anëtar i këshillit mbikëqyrës në shoqërinë “****” sh.a, e regjistruar me vendim nr. ***, datë 17.09.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT ***, larguar me vendimin e depozituar me ***, datë 31.07.2012. Bashkëlidhur ekstrakti i shoqërisë nga i cili rezulton se shoqëria “****” sh.a është regjistruar më datë 15.09.2001;

6.4 Më datë 04.06.2003, z. P.T. zotëron 8 % të aksioneve; zmadhim kapitali në masën 81.200.000 lekë. Më datë 26.01.2007, z. P.T. zotëron 8 % të aksioneve; zmadhim kapitali në masën 113.989.000 lekë. Më datë 18.12.2009, zmadhim kapitali në masën 178.436.000 lekë. Më 31.07.2012 është depozituar vendimi i asamblesë së aksionerëve, datë 25.6.2012, ku është vendosur pranimi i largimit të aksionerit P.T.; miratimi i kontratës së shkëmbimit me anë të së cilës vërtetohet shkëmbimi i aksioneve të z. P.T. me pasurinë e paluajtshme të shoqërisë; depozitimi i kontratës së shkëmbimit, datë 04.07.2012, nr. *** rep., nr. *** kol.

6.5 Lidhur me vlerën e shkëmbimit dhe vlerën reale të pasurisë së mësipërme konstatohet se:

- i. Në vitin 2012, nga shkëmbimi i aksioneve me vlerë 14.274.700 lekë është përfituar pasuria me sip. 519 m², në qendër tregtare ose me vlerë 27.360 lekë/m².
- ii. Vlera rezulton e ulët krahasuar me tregun, pasi vetëm vlera me kosto ndërtimi, sipas EKB (<http://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit/>) në vitin 2012 për qytetin e Korçës është 15.535.746 lekë (kosto ndërtimi 29.934 lekë/m²), ndërsa vlera me kosto shfrytëzimi është 18.917.550 lekë (kosto shfrytëzimi 36.450 lekë/m²). Nga ana tjetër, firma e zotëron këtë njësi prej vitit 2007, ku kosto e ndërtimit ka qenë 24.964 dhe e shfrytëzimit 29.874 lekë/m² ose 17.250.124 lekë me kosto ndërtimi ose 17.655.534 lekë me kosto shfrytëzimi. Pra, dukshëm, vlera e shkëmbimit të pasurisë nuk justifikon vlerën reale të saj.
- iii. Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin se pasuria është e llojit “njësi” dhe ndodhet në një godinë tregtare “****”, çmimi i saj sipas tregut është mbi 1.100 euro dhe nuk mund të jetë kurrsesi vlera me të cilën një shoqëri shet/shkëmben asetet e saj, pavarësisht se transaksioni kryhet me një nga ortakët e saj.

6.6 Në vitin 2012, bashkëshorti i subjektit ka shkëmbyer aksionet me vlerë 14.274.700 lekë dhe nga ky shkëmbim është përfituar pasuria me sipërfaqe 519 m², në qendër tregtare ose me vlerë 27.360 lekë/m².

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm.

Në lidhje me vlerën e shkëmbimit të aksioneve

6.7 Në deklaratën “Vetting”, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit deklaron se ka shkëmbyer aksionet me vlerë 14.274.700 lekë dhe nga ky shkëmbim është përfituar pasuria me sip. 519 m², në qendër tregtare ose me vlerë 27.360 lekë/m².

6.8 Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua se vlera për të cilën personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka fituar këtë aset, rezulton e ulët krahasuar me tregun. Vlera me kosto ndërtimi, sipas Entit Kombëtar të Banesave (<http://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit/>) në vitin 2012 për qytetin e Korçës është 15.535.746 lekë (kosto ndërtimi 29.934 lekë/m²), ndërsa vlera me kosto shfrytëzimi është 18.917.550 lekë (kosto shfrytëzimi 36.450 lekë/m²).

6.9 Firma “***” e zotëron këtë njësi prej vitit 2007, ku kosto e ndërtimit ka qenë 24.964 dhe e shfrytëzimit 29.874 lekë/m² ose 17.250.124 lekë me kosto ndërtimi ose 17.655.534 lekë me kosto shfrytëzimi.

6.10 Duket se vlera e aksioneve pjesë e shkëmbimit të pasurisë nuk justifikon vlerën reale të saj.

6.11 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se** vlera e ambientit të kaluar në pronësi të personit të lidhur/bashkëshortit të saj, nëpërmjet kontratës së shkëmbimit nr. *** rep. Nr. , *** kol., datë 04.07.2012, jo vetëm nuk është më e lartë se vlera e aksioneve të shkëmbyera por është me pak se e barabartë me to.

6.12 Ajo më tej shpjegon se, megjithëse ka disa vjet që ambientet kanë kaluar në pronësi të bankës nuk është bërë e mundur shitja e tyre tek të tretet nga ankandet e zhvilluara nga bankat.

6.13 Subjekti ka shpjegon se si provë për të provuar se nuk kanë pasur asnjë ofertë blerjeje megjithëse ka vite që janë nxjerrë për shitje, mund të verifikohet faqja web e bankës.

6.14 **Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se :**

6.15 Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur subjekti kanë fshehur vlerën reale të pasurisë “njësi” me sip. 519 m², në godinën “***” Korçë, me qëllim fshehjen e burimit të ligjshëm financiar për krijimin e saj për arsye se vlera e deklaruar e shkëmbimit është 14.274.700 lekë ose 27.360 lekë/m² / 200 euro/m², ndërsa vlera e tregut të saj është rreth 1.100 euro/m², vërtetuar kjo me anë të kostos mesatare të ndërtimit dhe shfrytëzimit sipas Entit Kombëtar të Banesave për vitin respektiv.

Në lidhje me burimin e ligjshëm të blerjes së aksioneve prej 8 % në shoqërinë “*”**

6.16 **Në deklaratë “Vetting”,** personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaron se kundër vlefte e vlerës së aksioneve të blera me krijimin e shoqërisë në vitin 2003, në masën 6.496.000 lekë.

6.17 Vlera e investuar në vitin 2003 për blerjen e këtyre aksioneve është marrë hua prej: (i) Shtetasit A.B. në masën 5.000.000 lekë me kontratën e huas datë 15.04.2003.5; (ii) 1.000.000 lekë hua nga prindërit e bashkëshortes, V. e A.P. Shuma e dhënë hua është pjesë e kursimeve të realizuara nga puna e tij dhe nënës së bashkëshortes e cila ka punuar deri në vitin 2008;

6.18 Për huadhënësit V. e A.P., pas shitjes së banesës së privatizuar nga shteti në vitin 1992, në bashkëpronësi me bashkëshorten, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.04.2005, noter M.B. Shuma e realizuar nga shitja është mbajtur e gjitha nga huadhënësit V. e A.P. duke konsideruar të shlyer huan e marrë nga vajza e tyre.

6.19 Për shtetasin A.B. ka filluar shlyerja në vitin 2008 e në vazhdim në vitet 2010, 2011, 2012 me pagesa periodike të ndryshme të pasqyruara edhe në deklaratat e pasurisë ndër vite.

6.20 **Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua se** huaja është shlyer me këste, si vijon: në vitin 2008 është shlyer shuma 1.000.000 lekë; në vitin 2010 është shlyer shuma 1.500.000 lekë dhe në vitin 2011 është shlyer shuma 1.500.000 lekë;

⁵Ky shtetas ka qenë aksioner i shoqërisë *** shpk me aktivitet në fushën e ndërtimeve, shoqëri e krijuar në vitin 1994. Shoqëria ka kryer aktivitet tregtar dhe ka ndarë fitime në vite sipas ekstraktit të QKR për këtë shoqëri tregtare dhe bilanceve të kësaj shoqërie, bashkangjitur kësaj deklarate. Shtetasi A.B. ka ndërruar jetë dhe trashëgimtare e tij është bashkëshortja, V.T., vajza e xhaxhait të P.T., tek e cila është kryer edhe pagimi i shumave të huasë gjatë kohës së shlyerjes së saj.

6.21 Ka mbetur detyrim i pashlyer shuma 1.000.000 lekë, për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk e ka pasqyruar në seksionin detyrime financiare, në deklaratën “Vetting” 2017.

6.22 Nuk është paraqitur dokumentacion ligjor provues në lidhje me shumën e dhënë hua nga ana e shtetasit A.B., në shumë 5.000.000 lekë.

6.23 Nuk është vërtetuar marrja dhe shlyerja e huas.

6.24 Nuk ka dokumentacion provues ligjor në lidhje me huan e marrë nga V. dhe A.P., prindërit e subjektit të rivlerësimit, në shumën 1.000.000 lekë, sipas deklaratës së subjektit të rivlerësimit;

6.25 V. dhe A.P. nga shitja e banesës së privatizuar kanë përfituar shumë prej 1.900.000 lekësh, sipas kontratës së shitjes, dhe pjesa takuese prej 1/3 e subjektit të rivlerësimit është respektivisht 650.000 lekë.

6.26 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se për sa i përket shlyerjes së shumës së marrë hua ashtu, ajo është shlyer përgjatë viteve 2008 deri në vitin 2012 me pagesa të vlerave të ndryshme deri në shlyerjen përfundimtare të saj.

6.27 Më tej subjekti shpjegon se në lidhje me mosdeklarimin e shlyerjes së këstit të fundit të detyrimit prej 1.000.000 lekësh, në deklaratën e vitit 2012, është një gabim në shkrim i deklaratës duke mos e pasqyruar si veprim shlyerjen e kësaj pjese të huasë në faqen e deklaratës që parashikon këtë lloj informacioni. Subjekti shprehet se pjesa e fundit e këtij detyrimi prej 1.000.000 lekësh, është shlyer pikërisht në vitin 2012, kohë kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare më të mëdha sepse kishin marr një kredi dhe kishin kursime të tjera nga të ardhurat e realizuara.

6.28 Për të vërtetuar shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit paraqiti si provë një deklaratë noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.09.2018, lëshuar nga shtetase V.B. bashkëshortja e të ndjerit A.B. e cila deklaroi para noterit se : “ Z. P.T. ka shlyer detyrimin ndaj ish burrit të saj dhe pas vdekjes se tij ndaj saj dhe në vitin 2012 ka shlyer këstin e fundit” pra e ka shlyer të gjithë huan në vlerën prej 5.000.000 lekësh dhe ska më detyrime ndaj saj.

6.29 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se :

6.30 Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, për shkak se ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor për marrjen dhe shlyerjen e huas prej 5.000.000 lekësh, që ka shërbyer si burim për blerjen e 8 % të kuotave të shoqërisë “****” sh.a.

6.31 Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në lidhje me shlyerjen e huas ndaj shtetasit A.B., për shkak se në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo hua është shlyer gjatë viteve 2008, 2010, 2011 dhe 2012, ndërsa sipas deklarimeve periodike vjetore të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, rezulton detyrim i mbetur në shumën 1.000.000 lekë.

6.32 Pretendimit të subjektit se “është një gabim në shkrim i deklaratës duke mos e pasqyruar si veprim shlyerjen e kësaj pjese të huas në faqen e deklaratës që parashikon këtë lloj informacioni...” , si dhe deklarata noteriale e datës 24.09.2018 nga shtetasja V.B., se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit e ka shlyer detyrimin ndaj ish-burrit të saj në vitin 2012, nuk u morën në konsideratë nga Komisioni për shkak se këto shpjegime dhe prova nuk provojnë me dokumentacion ligjor shlyerjen e huas nga ana e personit të lidhur.

6.33 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues për ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh të dhënë hua nga ana e të ndjerit A.B., sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

6.34 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të shlyer huan prej 1.000.000 lekësh, prindërve V. dhe A.P.

6.35 Personat e tjerë të lidhur, V. dhe A.P. kanë mungesë të burimit të ligjshëm financiar me dokumentacion justifikues ligjor për të dhënë huan prej 1.000.000 lekësh në vitin 2003, hua e cila ka shërbyer për blerjen e 8 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë “***” sh.a.

Në lidhje me pjesëmarrjen si aksioner me 8% të kuotave në shoqërinë “*” sh.a të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit**

6.36 Në deklaratën “Vetting”, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi se: “Shoqëria “***” sh.a nuk ka ndarë asnjë vit financiar dividende për aksionerët e shoqërisë dhe aksioneri, personi i lidhur/P.T., nuk ka marrë asnjë fitim nga shoqëria gjatë kohës së qenies së tij si i tillë”. Personi i lidhur më tej deklaroi se ky fakt provohet dhe me vërtetimin e DRT-së Korçë b/lidhur deklaratës.

6.37 Çdo e ardhur e krijuar nga shoqëria ka kaluar për rritjen e kapitalit të saj dhe rrjedhimisht të vlerës së aksioneve. Në vitin 2012 personi i lidhur/aksioneri P.T. zotëronte 9119 aksione, me vlerë 1.565.38 lekë për aksion, gjithsej vlera e aksioneve 14.274.700 lekë.

6.38 Nga hetimi në lidhje me këtë deklaram u konstatua se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si aksioner me 8 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë “***” sh.a., ka pasur fitim të pashpërndarë por që ka kryer rritje/zmadhim të kapitalit të shoqërisë përkatësisht në deklaratimet e interesave private “Periodike Vjetore” të viteve 2007 dhe 2009, dorëzuar pranë ILDKPKI-së.

6.39 Vlera e aksioneve të personit të lidhur/P.T. për këto vite është si më poshtë:

✓ 2003	6.000.000 lekë
✓ 2007	9.119.120 lekë
✓ 2009	14.274.880 lekë

6.40 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se, shoqëria “***” sh.a., është krijuar në vitet 2002 - 2003 me kontributin e ortakeve të saj si shoqëri tregtarë në të cilën personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka investuar në shumën 6.496.000 lekë.

6.41 Subjekti i rivlerësimit sollti si provë një vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë me nr. *** prot., datë 24.01.2017, ku citohet se : “Shoqëria “***” sh.a., nuk ka ndarë dividend po kjo vlerë gjatë viteve ka kaluar për shtimin e kapitalit”

6.42 Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se :

6.43 Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë fshehur pjesën takuese të fitimit në shoqërinë “***” sh.a, në deklaratimet periodike vjetore të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, si dhe rritjen e vlerës së aksioneve si rrjedhim i rritjes së kapitalit në shumën 6.000.000 lekë në vitin 2003; shumën 9.119.120 lekë në vitin 2007 dhe shumën 14.274.880 lekë në vitin 2009.

6.44 Referuar nenit D “Vlerësimi i Pasurisë”, pika 3, “subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrime tatimore...”.

6.45 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të vërtetuar ligjshmërinë e të ardhurave nga fitimi i krijuar gjatë viteve 2007 - 2009, fitim i cili ka kaluar në rritje të kapitalit të shoqërisë.

6.46 Për fitimin që ka kaluar në rritje të kapitalit në vlerë 14.274.700 lekë dhe nga ky shkëmbim është përfituar pasuria me sip. 519 m², në qendër tregtare ose me vlerë 27.360 lekë/m², Drejtoria Rajonale Korçë konfirmon se nuk është paguar tatim mbi fitimin.

6.47 Për rrjedhojë këto të ardhura nuk konsiderohen si të ardhura të ligjshme dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen si burim për përfitimin e njësisë me sipërfaqe 519 m² ndodhur në godinën “****”, në Korçë.

6.48 Bazuar në sa më lart shpjeguar, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shkëmbimin e 8 % të kuotave (në vlerë 6.496.000 lekë), me njësinë me sipërfaqe 519 m², ndodhur në godinën “****”, në Korçë.

6.49 Për sa i përket, vërtetimit të dërguar subjekti i rivlerësimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë me nr. *** prot. datë 24.01.2017, ky dokument ka konfirmuar vetëm që shoqëria “****” Sh.A., nuk ka ndarë dividend dhe që kjo vlerë gjatë viteve ka kaluar për shtimin e kapitalit, por nuk provoi se ishin paguar detyrimet tatimore

7. Pasuri të pa deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe/ose Deklarata Vjetore pranë ILDKPKI-së, të konstatuara nga hetimit administrativ

1. Depozitimi i shumës 2.000.000 lekë në llogarinë e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit

1.1. **Nga hetimi administrativ, u konstatua se në llogarinë e personit të lidhur /bashkëshortit të subjektit, më datë 18.03.2009, është depozituar në llogari e tij bankare, pranë “Credins Bank” shuma prej 2.000.000 lekësh. Kjo shumë nuk rezulton e deklaruar në deklarin vjetor të vitit 2008 pranë ILDKPKI-së.**

1.2. **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se shuma e deklaruar në këtë vit përfaqëson vlerën e lekëve të tërhequra nga bonot e thesarit, nga babai i bashkëshortit të saj në fund të vitit 2008 dhe kalimin si dhuratë të kësaj shume në llogarinë e bashkëshortit në “Credins Bank”.**

1.3. Ky veprim është deklaruar nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit në deklaratën vjetore të viti 2008 si dhuratë nga prindërit në shumën prej 1.920.000 lekësh, dhe është kjo shumë me shtesat për rrumbullakosjen e saj ka kaluar në llogari personale të bashkëshortit

1.4. **Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se, subjekti i rivlerësimit ka fshehur depozitimin e kësaj shumë në llogarinë e personit të lidhur bashkëshortit, në deklarin vjetor të vitit 2008.**

1.5. **Provat mbi të cilat mbështetet përfundimi i Komisionit janë:**

- i. Dokumentet e administruara nga “Credins Bank”;
- ii. Deklaratën Vjetore të vitit 2008.

2. **Kreditimi në llogarinë e personit të lidhur pranë “Credins Bank” të shumës prej 70.000 USD-sh, me trasfertë nga “Alpha Bank”.**

2.1 **Nga hetimi administrativ, u konstatua se** më datë 21.10.2008, në “Credins Bank” është kredituar llogaria me 70.000 USD me transfertë nga “Alpha Bank”. Shuma është arkëtuar me çek no. ***, datë 20.10.2008, në “Alpha Bank”, dega ***, z. V.O., Selanik.

2.2 Nga verifikimi i mëtejshëm me “Alpha Bank”, rezulton se çeku nuk është lëshuar nga “Alpha Bank”, por ky çek është lëshuar në emër të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit nga “Alpha Bank” A.E.

2.3 Komisioni verifikoi të dhënat me “Alpha Bank” A.E, në lidhje me këtë shumë.

2.4 Më tej, rezulton se subjekti i rivlerësimit nga llog. e cekut 70.000 USD ka tërhequr *cash* shumën prej 40.000 USD, më datë 22.11.2008, por që nuk e ka deklaruar në Deklarimin Vjetor të vitit 2008.

2.5 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se** shuma prej 70.000 USD kredituar në llogarinë e personit të lidhur/bashkëshortit nuk është shumë që i përkiste subjektit. Sipas subjektit ajo ka qenë pasuri e shtetases E.Dh. mikeshë e familjes së tyre që ushtron profesionin e avokates në Selanik, Greqi. Në vitin 2008 ajo planifikoi kryerjen e një investimi në qytetin e Korçës meqenëse ka banuar në fëmijëri në këtë qytet, dhe kërkoi nga bashkëshorti im të interesohej për këtë investim dhe për kryerjen e procedurave të blerjes. Shuma në fjalë, që përfaqëson të ardhurat e krijuara prej saj nga aktiviteti provat që ushtron, është dërguar nga Greqia në rrugë bankare prej saj në emër të personi i lidhur/bashkëshortit për të mundësuar aksesin e tij në rast se do të duhej për pagesën e shpenzimeve të ndryshme që do të nevojiteshin. Pavarësisht kalimit të shumës në emër të personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në sportelin e bankës është paraqitur vete kjo shtetase për të tërhequr në dy raste sasi të ndryshme nga kjo shumë, fakt që provohet edhe me deklaratën e kësaj shtetaseje.

2.6 Më tej subjekti shpjegon se personi i lidhur është pyetur nga një përfaqësues i ILDKPI-së për këtë situatë, në vitin 2009 dhe pas shpjegimeve të dhëna prej tij nuk është gjetur asnjë situatë fshehjeje apo mosdeklarimi nga ky institucion.

2.7 **Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se:**

- i. subjekti i rivlerësimit ka fshehur kreditimin e shumës prej 70.000 eurosh në llogarinë e personit të lidhur/bashkëshortit nga “Alpha Bank”, me qëllim mosdeklarimin e burimit të ligjshëm për krijimin e kësaj depozite. Kjo shumë nuk është deklaruar në deklaratë e interesave privatë “Periodike Vjetore 2008”;
- ii. subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin dhe ligjshmërinë e kësaj shume të depozituar në llogarinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit;
- iii. subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacioni ligjor justifikues financiar për të krijuar depozitën në shumën prej 70.000 USD nga “Alpha Bank” .

2.8 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kjo ka qenë pasuri që nuk i përkiste atyre por shtetases E.Dh., mikeshë e familjes, nuk qëndron pasi subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar shpjegimin e saj.

2.9 Më tej subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një deklaratë të kësaj shtetaseje për të vërtetuar shpjegimet e saj, por që Komisioni çmon se kjo deklaratë nuk duhet marrë në konsideratë pasi nuk ka fuqinë e një prove të plotë ligjore për të vërtetuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

2.10 Provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i Komisionit janë:

- i. Deklarata e interesave private “Periodike Vjetore 2008” pranë ILDKPKI-së administruar nga Komisioni;
- ii. Dokumentacionin e administruar nga “Credins Bank” dhe “Alpha Bank”.

3. Depozitë në emër të z. P.T. në shumën 10.323 euro, datë 31.12.2003, dhe 0 euro, datë 31.12.2004. në “ProCredit Bank”.

3.1 **Nga hetimi administrativ u konstatua se**, personi i lidhur dispononte një llogari në shumën prej 10.023 eurosh, datë 31.12.2003, dhe më datë 31.12.2004, kjo llogari ishte 0 (zero) në “ProCredit Bank”.

3.2 Në deklaratën vjetore 2003, u konstatua se kjo llogari depozite nuk ishte deklaruar nga ana e subjektit.

3.3 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se**, shuma prej 10.323 eurosh përfaqëson vlerën e paguar prej subjekti të rivlerësimit për shlyerjen përfundimtare të kredisë së marrë në vitin 2001 pranë “FEFAD” Bank, sot “ProCredit Bank”. Ne vitin 2003 pas pagesave të kësteve të kredisë subjekti ka vendosur shlyerjen totalisht të pjesës së mbetur të saj dhe në marrëveshje me përfaqësues së bankës ka konkluduar me mbylljen e kredisë në muajin 2003.

3.4 Për këtë veprim janë kryer edhe procedurat përkatëse me bankën duke u nënshkruar në fund të procesit edhe deklarata e përfaqësuesve të saj, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14. 04. 2003, paraqitur si provë. Marrëdhënia e subjektit me bankën për sa i përket kredisë së marrë është mbyllur që në vitin 2003, duke mos pasur llogari të tjera në euro pas përfundimit të kontratës së kredisë.

3.5 **Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se**, subjekti i rivlerësimit ka fshehur depozitën prej 10.023 eurosh në deklaratën e interesave private “Deklarimi për herë të parë” të vitit 2003.

3.6 **Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar destinacionin/pakësimin e kësaj shume në deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2004”**

3.7 Nga analiza financiare e të ardhurave, pasurive dhe detyrimeve të vitit 2003, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare me dokumentacion ligjor provues për të justifikuar depozitën në shumën prej 10.023 eurosh, pranë “Credins Bank”.

3.8 Provat mbi të cilat bazohet përfundimi i Komisionit janë:

- i. Deklarata e interesave private, për herë të parë e vitit 2003, pranë ILDKPKI-së, administruar nga Komisioni;
- ii. Deklarata e interesave private, periodike vjetore 2004, pranë ILDKPKI-së, administruar nga Komisioni;
- iii. Dokumentacioni i administruar nga “Credins Bank”.

4. Depozitimi cash në shumë prej 12.045 USD, në “Bankën Kombëtare Greke” (NBG) dhe transferta në Detroit Michigan, SHBA.

4.1 **Nga hetimi administrativ u konstatua se** personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit/bashkëshorti i saj, më datë 01.06.2002 ,ka depozituar *cash* në llogarinë rrjedhëse në USD shumë prej 12.045 USD , në “Bankën Kombëtare Greke” (NBG).

4.2 Më tej më datën 07.06.2002, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit po të njëjtën shumë depozituar si më lart e ka transferuar në një llogari, sipas tij , “kredi personale” në Detroit Michigan, SHBA.

4.3 **Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë transfertë në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore shpjegoi se,** kjo shumë i është dërguar motrës së personit të lidhur që jeton në SHBA . Në shpjegimet përfundimtare të dërguara Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk jep shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

4.4 **Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi , arrin në konkluzionin se,**duke përdorur arsyetimin kohor, logjik dhe aritmetik të kësaj shume në raport me faktet e tjera të dala nga hetimi, del në konkluzionin se kjo shumë e transferuar në SHBA, përputhet në fakt me shumë prej 1.800.000 lekësh të shitjes së apartamentit të motrës së z. P.T. në vitin 2002.

4.5 Komisioni, bazuar në këtë arsyetim, arrin në përfundimin se kjo shumë pas shitjes së apartamentit, më datë 06.06.2002, është transferuar në SHBA, më datë 07.06.2002.

4.6 Në lidhje me transfertën, Detroit Michigan, SHBA, të shumës prej 12.000 USD, Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklarin e interesave privatë deklarim për herë të parë të vitit 2003, transfertën e kryer në Detroit Michigan, SHBA, për shitjen e shtëpisë.

4.7 **Provat mbi të cilat bazohet rezultati i Komisionit janë:**

- i. Dokumentacioni i administruar nga “Banka Kombëtare e Greqisë” (NBG).

5. **Depozitimi *cash* i shumës prej 3.600.000 lekësh, datë 17.08.2007, konvertim i shumës në 29.629 euro dhe tërheqje *cash*, më datë 02.10.2007, në “Credins Bank”.**

5.1 **Nga hetimi administrativ i Komisionit,** më konkretisht analizimi i dokumentacionit të administruar nga ana e “Credins Bank”, u konstatua se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer një depozitim *cash* në shumë 3.600.000 lekë, më datë 17.8.2007, e ka konvertuar atë në monedhën euro 29.629 dhe e ka tërhequr *cash*, më datë 2.10.2007, pranë “Credins Bank”.

5.2 Nga analiza financiare e kryer për vitin 2007, Komisioni, konstaton se nuk ka mjaftueshëm burime të ligjshme financiare për të justifikuar këtë shumë në vlerën prej 3.600.000 lekësh.

5.3 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se,** kjo shumë ka qenë e shtetasit L.L., mik fëmijërie me personin e lidhur/bashkëshortin e subjektit, si një person që ushtron aktivitet tregtar në qytetin e Korçës prej vitesh.

5.4 Subjekti më tej shpjegon se arsyeja që veprimi është regjistruar nga banka në emër të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit është përfitimi i një kursi preferencial prej tij nga banka, më i mirë se ai që i ishte ofruar shtetasit L.L.. Kjo është arsyeja që ky veprim bankar është regjistruar në emër të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit.

5.5 Për të provuar shpjegimet e saj në lidhje me faktin se këto veprime janë kryer brenda ditës, subjekti i rivlerësimit paraqet si provë dokument “*statment*” nga banka. Më tej për të

provuar që kjo shumë është marrë nga shtetasi L.L., subjekti ka paraqitur si provë një deklaratë noteriale dhënë para noterit nga ky shtetas.

5.6 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se, subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2007” shumën prej 3.600.000 lekësh.

5.7 Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues të kësaj shume dhe rezultoi me mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor për të provuar shumë prej 3.600.000 lekësh

5.8 Pretendimi i subjekti të rivlerësimit se “*kjo shumë ka qenë e shtetasit L.L., mik fëmijërie me personin e lidhur/bashkëshortin e subjektit...*”, nuk qëndron, për arsye se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor pretendimet e saj se këto ishin të ardhura të shtetasit L.L. Deklarata noteriale e paraqitur nga ky shtetas ka vetëm efekt deklarativ dhe jo provues.

6. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. P.T.

6.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit deklaroi se, ka të ardhura si më poshtë:

- i. Të ardhura nga kontrata e qirasë, datë 05.03.2012, me subjektin “****” sh.p.k., për periudhën mars 2012 - mars 2013, pas zbritjes së vlerës së tatim fitimit. Vlera 32.400 euro.
- ii. Të ardhura nga kontratat e qirasë me subjektin “****” sh.p.k., administratore V.Sh., për periudhën janar 2014 - dhjetor 2016, pas zbritjes së vlerës së tatim fitimit. Vlera 7.056.000 lekë.
- iii. Të ardhura nga kalimi në llogarinë personale nga bonot e thesarit, dhuratë nga prindërit në vitin 2008. Vlera 1.926.000 lekë.
- iv. Të ardhura dhuratë nga babai B.T., në vitin 2008. Të ardhura të krijuara nga kursimet në vite të tij. Vlera 500.000 lekë.
- v. Të ardhura dhuratë nga babai B.T. në vitin 2012. Pagar për blerjen e apartamentit, me sip. 55 m², ndodhur në Rr. “****”, me aktmarrëveshje premtim shitje. Kontrata e shitjes realizuar nga z. P.T. për shkak të vdekjes së babait, B.T. Vlera 1.600.000 lekë.

6.2 Nga hetimi administrativ i Komisionit u konstatua se:

Në lidhje me të ardhura nga kontrata e qirasë, datë 05.03.2012, me subjektin “**” sh.p.k.**

6.3 Shoqëria “****” sh.p.k., ka filluar ushtrimin e aktivitetit me adresë: Lagja Nr. ***, Bulevardi “****”, Korçë, pranë godinës në pronësi të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, më datë 13.08.2012, vërtetuar kjo me vendimin e asamblesë së ortakëve për hapjen e NIPT-it sekondar për ushtrim aktiviteti në një adrese dytësore, depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6.4 Kontrata e qirasë ndërmjet personit të lidhur/z. P.T. dhe shoqërisë “****” sh.p.k është nënshkruar, më datë 05.03.2012, pra 5 muaj para se të regjistrohej NIPTI sekondar.

6.5 Sa sipër rezulton se, shoqëria “****” sh.p.k ka kryer aktivitet ligjor në këtë godinë vetëm gjatë periudhës 13.08.2012 - 02.12.2013 (dhe jo nga mars 2012 sikurse është deklaruar), prej të cilës nga prill 2013 - dhjetor 2013, nuk ka paguar qira sipas aktmarrëveshjes, datë 14.01.2013.

6.6 Më tej, shoqëria “****” sh.p.k., ka mbyllur aktivitetin e saj, më datë 02.12.2013, vërtetuar kjo me të dhënat nga Qendra Kombëtare e Biznesit ku dhe verifikohet depozitimi i vendimit të asamblesë, datë 02.12.2013, ku është vendosur mbyllja e NIPT-it sekondar me adresë: Lagja ***, Bulevardi “****”, Korçë.

6.7 Ndërmjet personit të lidhur/z. P.T. dhe administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., znj. Z.Sh. është rënë dakord që nga ana qiramarrësi të kryhen punime të brendshme arredimi për kthimin e saj në lokal shërbimi nga muaji prill 2013 - dhjetor 2013, referuar kjo aktmarrëveshjes midis palëve të datës 14.01.2013.

6.8 Bazuar në sa më lart, rezulton se të ardhurat e përfituara prej personit të lidhur/z. P.T. nga qiraja janë për një periudhë 7 mujore, në vlerën 18.900 euro (*pas zbritjes së tatimit në burim*).

Në lidhje me vlerën e investuar nga shoqëria “**” sh.p.k për arredimin e ambienteve të marra me qira.**

6.9 Sipas aktmarrëveshjes, datë 14.01.2013, midis pronarit të banesës z. P.T. dhe administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., znj. Z.Sh., është rënë dakord që për periudhën prill - dhjetor 2013, objekti të mbahet në përdorim nga qiramarrësi Z.Sh., pa kundërshpërblim; qëllimi i përdorimit të banesës do të jetë përshtatja e saj në lokal shërbimi, i cili do të përdoret nga qiramarrësi, shoqëria “****” sh.p.k, në të ardhmen si i tillë. Me kryerjen e punimeve për përshtatjen e ndërtesës palët do të bisedojnë për lidhjen e një kontrate të re qiraje.

6.10 Sipas së njëjtës kontratë palët nuk kanë përcaktuar se sa janë shpenzimet e nevojshme që do të kryhen apo që janë kryer nga shoqëria “****” sh.p.k.

6.11 Më tej nga hetimi u konstatua se bashkëlidhur aktmarrëveshjes nuk ka asnjë preventiv apo situacion punimesh në të cilin të rezultojë se sa ka qenë vlera e investuar në përshtatjen e kësaj banese në lokal shërbimi.

6.12 Sipas pamjeve fotografike dhe regjistrimit filmik nga “Agonland”, godina është e mirë arreduar në të katër katet e saj, me pajisje bashkëkohore dhe luksoze, dukshëm të kushtueshme për funksionimin normal të çdo ambienti të dedikuar sipas kateve dhe funksionaliteteve përkatëse.

6.13 Kundërshpërblimi i shoqërisë “****” sh.p.k, sipas aktmarrëveshjes, datë 14.01.2013, për periudhën prill - dhjetor 2013, i cili llogaritet të jetë rreth 27.000 euro (3.000 euro ka qenë qira mujore*9 muaj), nuk justifikon kurrësi vlerën e dukshme të arredimit dhe kthimit të ambienteve në lokale shërbimi.

6.14 Më tej, më datë 05.01.2014, personi i lidhur/z. P.T. si qiradhënës ka lidhur kontratë qiraje (të pa noterizuar) me shoqërinë “****” sh.p.k., si qiramarrëse për ndërtesën ndodhur në Bulevardin “****”, Nr. ***, Korçë. Pra, nga viti 2014 e në vazhdim, objekti funksionon si lokal shërbimi në administrim të shoqërisë “****” sh.p.k, dhe jo nga shoqëria “****” sh.p.k., e cila, sipas deklaramit ka bërë edhe investimet e duhura për përshtatjen e banesës në lokale shërbimi.

Në lidhje të ardhura nga kontratat e qirasë me subjektin “**” sh.p.k, administratore V.Sh. për periudhën janar 2014 - dhjetor 2016, pas zbritjes së vlerës së tatim fitimit. Vlera 7.056.000 lekë**

6.15 Nga ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “****” sh.p.k, shkarkuar nga faqja *online* e QKB-së, rezulton se shoqëria është themeluar, më datë 10.01.2014, por data e regjistrimit është 12.03.2015. Në QKB janë depozituar pasqyrat financiare prej datës 01.11.2015 - 31.12.2015, fakte këto që tregojnë se shoqëria nuk ka pasur dhe nuk ka zhvilluar aktivitet gjatë vitit 2014.

6.16 Shoqëria për vitin 2015 rezulton, me humbje në vlerën 919.130 lekë; më datë 31.10.2015, me fitim 203.754 lekë dhe në vitin 2016 me fitim 114.119 lekë, ndërkohë që vetëm shpenzimet për qira janë nga 240.000 lekë/muaj ose 2.880.000 lekë/vit.

6.17 Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, nuk konfirmon shlyerje të detyrimeve tatimore nga shoqëria “****” sh.p.k për periudhën e dhënë me qira për vitin 2014.

6.18 Në deklarinimin e interesave private “Periodike Vjetore 2014” janë deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 2.000.000 lekë.

6.19 Sipas kontratës datë 05.01.2014, paraqitur nga subjekti, vlera e qirasë është 200.000 lekë/muaj dhe shuma është përfshirë në të ardhurat e deklaruara në deklarinimin “Vetting”.

6.20 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat e interesave private “Periodike Vjetore 2012, 2013, 2014 dhe 2015” të ardhura nga qiraja si më poshtë:

- i. për vitin 2012 - 27.000 euro;
- ii. për vitin 2013 - 9.000 euro;
- iii. për vitin 2014 - 2.000.000 lekë;
- iv. për vitin 2015 - 2.400.000 lekë dhe
- v. për vitin 2016 - 2.400.000 lekë plus 2.200 euro.
- vi. Në total 6.800.000 lekë dhe 38.200 euro.

6.21 Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, me anë të shkresave nr. *** prot., datë 27.03.2018. dhe nr. *** prot., datë 18.04.2018, konfirmon se shoqëria “****” sh.p.k., ka paguar tatim në burim për objektin e marrë me qira vetëm në vitin 2012 dhe vitin 2013 në vlerat 412.500 lekë dhe 123.660 lekë dhe pagesa në burim nga shoqëria “****” sh.p.k për periudhën gusht 2015 deri dhjetor 2016

Në lidhje me të ardhura nga kontrata e qirasë për banesën e ndodhur në Bulevardin “**”, pall. **, për vitin 2016 me shoqërinë “****”, Itali. Vlera 2.200 euro.**

6.22 Nuk ka subjekt me këtë emër në sistemin informatik, konfirmuar me anë të shkresës nr. *** prot., datë 21.12.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, lidhur me kontratën e qirasë me “****”, Itali.

6.23 Drejtoria Rajonale Korçë nuk konfirmon të jenë paguar detyrimet tatimore

Në lidhje me të ardhura nga prindërit e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit në shumë totale prej 4.026.000 lekësh.

6.24 Nuk konfirmohen periudha e kontributive apo pension pleqërie prej vitit 2012 e në vijim, vërtetuar me anë të shkresës nr. **, datë 11.07.2017, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

6.25 Rezulton se nuk ka të dhëna për të ardhurat nga punësimi deri më datë 31.12.2012, në emër të z. B.H.T. dhe znj. F.H.T., prindërit e b/shortit të subjektit të rivlerësimit, vërtetuar me anë të shkresës nr. ***, datë 29.12.2017 (***, datë 26.12.2017) nga DRT-së Korçë.

6.26 Pra, të ardhurat/dhuratë nga prindërit në shumën totale 4.026.000 lekë (1.926.000/2008 + 500.000/2008 + 1.600.000/2012), nuk konfirmohen nga institucionet përgjegjëse, duke rezultuar deklarim i rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për to.

6.27 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se:**

Në lidhje me të ardhura nga kontrata e qirasë, datë 05.03.2012, me subjektin “**” sh.p.k.**

6.28 Personi i lidhur/bashkëshorti i subjekti ka lidhur kontratën e qirasë me firmen “****” sh.p.k në muajin mars të vitit 2012 dhe nga ky muaj ka filluar edhe zbatimi i kushteve të kontratës. Nga ana e bashkëshortit të saj është dorëzuar objekti në gjendjen e tij pas rikonstruksionit dhe nga pala qiramarrëse është filluar pagesa e vlerës së qirasë.

6.29 Këto fakte, shpjegon subjekti i rivlerësimit provohen edhe me pagesat e vlerave të qirasë të realizuar nga pala qiramarrëse për të cilën është mbajtur prej saj vlera e tatim fitimit në formën e tatimit në burim sipas kërkesave të ligjit. Këto rrethana provohen edhe nga aktet shkresore që subjekti i ka bashkangjitur deklaratës “Vetting”.

6.30 Në lidhje me ushtrimin e aktivitetit tregtar nga “****” sh.p.k., në këtë godinë dhe momentin e hapjes së NIPT sekondar, subjekti i rivlerësimit shpjegon se kjo mospërputhje nuk përbën shkak për mosjustifikimin e vlerës së paguar të qirasë prej këtij subjekti.

6.31 Subjekti më tej shton se në këtë ambient nuk është ushtruar asnjëherë veprimtari tregtare shitje blerje por vetëm është shfrytëzuar për ambiente zyrash, takimesh me kontraktorë dhe ekspozim i produkteve të kompanisë, aktivitete këto që në bazë të ligjit nuk kërkojnë regjistrim specifik.

6.32 Lidhur me vlerën e pagimit të tatimit për këtë të ardhur të realizuar duke qenë se personi i lidhur/bashkëshorti i subjekti nuk është subjekt tregtar i regjistruar, pagesa e tatimit për vlerën e qirasë është kryer nga subjekti “****” sh.p.k., per llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë sipas përcaktimeve të nenit 33 dhe të ligjit nr. 8438 në formën e mbajtjes në burim e tatimit mbi të ardhurat.

6.33 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se, këto fakte kanë qenë të provuara prej subjektit me dokumentacionin provues ligjor si vërtetime banke, vërtetim i DRT-së Korçë, si në deklaratat vjetore të dorëzuara pranë ILDKPI-së ashtu dhe në deklaratën “Vetting”.

Në lidhje me vlerën e investuar nga shoqëria “**” sh.p.k për arredimin e ambienteve të marra me qira**

6.34 Subjekti i rivlerësimit vlerëson se si qiradhënës personi i lidhur/bashkëshorti i saj nuk ka asnjë detyrim ligjor të provojë vlerën e investuar në banesë nga shoqëria “****” sh. p.k për përshtatjen e banesës në pronësi të personit të lidhur në lokal shërbimi, për sa kohë ky investim nuk kryhej me të ardhurat e tij personale dhe në asnjë moment nuk ka pasur dijeni dhe nuk i është njoftuar nga qiramarrësi kjo vlerë.

6.35 Më tej subjekti shprehet se pavarësisht situatës ligjore mes palëve dhe respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të tyre të rrjedhura nga kontrata e qirasë, pas gjetjeve të Komisionit, sipas të cilave më kërkohen shpjegime për këtë situatë, subjekti ka kontaktuar me përfaqësuesin e shoqërisë “****” sh.p.k., i cili më ka venë në dispozicion disa fatura në lidhje me shpenzimet e kryera për përshtatjen e banesës në ambient shërbimi si dhe me ka shpjeguar

se punimet janë kryer prej tij me skuadra ndërtimi të specializuara në fusha të caktuara si mobilje, ndriçim, hekurpunues, gurgdhendës, prodhues banakësh profesionale dhe persona të tjerë me të cilët i ka të zgjidhura edhe marrëdhëniet financiare duke kryer pagesat përkatëse.

6.36 Investimet e kryera prej qiramarrësit janë përballuar nga të ardhurat e tij të realizuara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të shoqërisë “****” sh.p.k për një periudhë shumë të gjatë kohore, të justifikuar si të ardhura të ligjshme të aktivitetit tregtar dhe për të cilat janë paguar të gjitha detyrimet që kërkohen në shtet si tatim fitimi, TVSH, detyrime taksash e çdo detyrim tjetër.

6.37 Subjekti i rivlerësimit kërkoi që shtetasi Z.Sh., banues në Korçë, të pyetet me cilesinë e dëshmitarit në lidhje me sa konstatohet nga Komisioni duke dhënë përgjigje më të sakta për investimin e kryer në objekt.

Në lidhje me shlyerjen e detyrimeve tatimore ndaj shtetit për tatimin mbi qiranë të kontratës subjekti shpjegon se:

6.38 Tatimi në burim për të ardhurat e realizuara nga kontrata e qirasë mes personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., është paguar prej kësaj të fundit në llogarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, sipas kërkesave të ligjit në masën 10 % të vlerës së qirasë, duke e vërtetuar këtë me një dokument të lëshuar nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

6.39 Për sa i përket pagimit të tatimit mbi qiranë në bazë të kontratës së qirasë midis personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në vitin 2014 si në deklaratat vjetore dhe në deklaratën “Vetting” ka paraqitur dokumentacionin ligjor justifikues për pagesat e kryera në DRT-në Korçë nga shoqëria *** sh.p.k.

6.40 Subjekti i rivlerësimit në lidhje me kohën e regjistrimit të shoqërisë “****” sh.p.k. si person juridik, shpjegon se shoqëria “****” sh.p.k ishte në krijim e sipër në momentet e nënshkrimit të kontratës së qirasë dhe është regjistruar pranë QKR-së, më datë 10. 01. 2014. Diferencat prej 5 ditësh midis të cilave përfshihet edhe fundjava nuk përbëjnë shkak parregullsie.

6.41 Subjekti më tej shpjegon se, në kontratën e qirasë është përcaktuar edhe kushti i pagimit të tatimit në burim për vlerën e qirasë prej qiramarrësit si detyrim ligjor i rrjedhur nga ligji për tatimin mbi të ardhurat.

6.42 Në lidhje me konstatimin se shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., janë shoqëri që kanë lidhje me njëra tjetrën pasi administratorja e shoqërisë “****” sh.p.k është bashkëshorte dhe njëkohësisht financiare e shoqërisë “****” sh.p.k, qëllimi i hapjes së një aktiviteti shërbimi është kryesisht marketingu i produkteve të shoqërisë “****” sh.p.k., si kafe, pije alkoolike dhe joalkoolike, produkte bari dhe restoranti. Për këtë arsye investimi për përshtatjen e godinës në ambient shërbimi është kryer nga shoqëria “****” sh.p.k dhe me pas i ka kaluar shoqërisë “****” sh.p.k. Vetë shoqëritë kanë kryer kalim asetesh e pajisjesh në llogaritë financiare të njëra tjetrës. Bashkangjitur raportit subjekti ka paraqitur vërtetimet e DRT-së Korçë, për pagimin e tatimit në burim nga subjektet “****” sh.p.k dhe “****” për të gjitha vitet e posedimit të pronës prej tyre në bazë të kontratave të qirasë të lidhura me pronarin P.T., lëshuar nga DRT-ja Korçë mbi kërkimin e informacionit nga këto subjekte.

6.43 Për sa i përket pagesave të qirasë për vitet 2015 e 2016 të rrjedhura nga kontratat e qirasë të lidhura midis personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit dhe administratorës së shoqërisë “****” sh.p.k., subjekti shpjegon se pagesat e qirasë janë kryer nga administratorja e shoqërisë rregullisht sipas vlerave të përcaktuara nga kontrata dhe pas zbritjes së tatimit mbi

të ardhurat të mbajtur në burim prej saj sipas kërkesave të ligjit për tatimin mbi të ardhurat neni 33 i tij.

6.44 Subjekti kishte kontaktuar administratoren e shoqërisë “****” sh.p.k., e cila kishte shpjeguar se pavarësisht mungesës së fitimit të realizuar, biznesi të cilin ajo ushtron është i llojit të tillë që do kohën e vet të maturimit dhe nxjerrjes së fitimeve. Pavarësisht mungesës së fitimit ajo ka realizuar marketingun e produkteve të shoqërisë “****” sh.p.k, kryesisht atë të prodhimit dhe shitjes së kafes expres, si bashkëshorte e administratorit të kësaj shoqërie dhe me qëllime ekonomike të përbashkëta, marketing i cili ka shtuar aktivitetin e shoqërisë “****” sh.p.k., duke rritur të ardhurat e kësaj shoqërie.

6.45 Për të dhënë sqarime të mëtejshme në lidhje me aktivitetin e kryer dhe bashkëveprimin e të dy shoqërive “****” dhe “****”, subjekti i rivlerësimit, kërkoi nga Komisioni të pyetej me cilësinë e dëshmitares shtetesja V.Sh., e cila do të shpjegonte më qartë dhe në mënyrë profesionale këtë situatë.

Në lidhje me të ardhura nga kontrata e qirasë për banesën e ndodhur në Bulevardin “**”, pall. ***, për vitin 2016, me shoqërinë “****”, Itali. Vlera 2.200 euro**

6.46 Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shoqëria “****”, shpjegoj se, në vitin 2016 midis personi të lidhur/bashkëshorti të subjektit dhe shtetasit italian P.T. është lidhur një kontratë qiraje për banesën e ndodhur në: Bulevardi “****”, në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe djalit të saj. Kontrata ka përcaktuar kohëzgjatjen e saj dhe vlerën e qirasë dhe është nënshkruar rregullisht nga palët duke përbërë provë të plotë për vlefshmërinë e saj sipas ligjit. Shtetasi P.T. ka ardhur në qytetin e Korçës për llogari të kompanisë italiane ku ai punonte “****” me seli të aktivitetit të saj në Perugia, Itali, dhe sipas bisedës më të në momentet e marrëveshjes për lidhjen e kontratës, sqaroi se vlera e qirasë do të paguhej nga kompania e tij.

6.47 Për këtë arsye në komunikim me *email* i subjekti i ka dërguar të dhënat e llogarisë bankare në euro pranë “Credins Bank” ku dhe është kryer pagesa nga kompania “****” me seli në Itali. Subjekti më tej shpjegon se shoqëria “****” nuk ka pasur seli në Republikën e Shqipërisë dhe nuk ka qenë e regjistruar në DRT-në Korçë dhe për këtë shkak kjo drejtori nuk mund të japë të dhëna për shoqërinë dhe as ekzistencën e kontratës së qirasë dhe për pagesën e vlerës së saj.

6.48 Në lidhje me pagimin e tatimit mbi të ardhurat shpjegoj se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka detyrim për të plotësuar deklaratën vjetore të të ardhurave duke qenë subjekt që realizon mbi 2.000.000 lekë të ardhura në vit sipas nenit 13 të ligjit mbi të ardhurat. Në plotësim të këtij detyrimi ligjor nga ana e personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit në vitin 2017 është plotësuar deklaratata e të ardhurave të realizuara për vitin 2016 dhe pas plotësimit të saj është paguar edhe tatimi i të ardhurave të qirasë nga kontrata e qirasë sipas përcaktimeve ligjore.

6.49 Duke qenë se deklaratata vjetore plotësohet deri më datë 30 prill të vitit tjetër të deklarimit, pagimi i këtij detyrimi nuk është deklaruar në deklaratën vjetore të vitit por është llogaritur në deklaratën “Vetting” duke qenë se në këto momente ky detyrim ka qenë i paguar dhe shlyer.

6.50 Për sa i përket diferencave të konstatuara nga Komisioni për vlera të qirasë në deklaratat vjetore dhe në deklaratën “Vetting”, subjekti vlerëson se në rastin konkret për sa i përket diferencës së shumave në euro, ajo shumë përfaqëson tatimin e fitimit në burim të pagesave të qirasë e cila është zbritur në deklaratën “Vetting”, ndërsa në deklaratën e viti përkatës është deklaruar si vlerë bruto. Diferenca në lek përfaqëson gabim në shkrim në deklaratën “Vetting” pasi shuma duhet të ishte 5.000.000 lekë pas zbritjes së tatimit mbi të ardhurat.

Në lidhje me të ardhura nga prindërit e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit në shumë totale prej 4.026.000 lekësh.

6.51 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se për sa i përket të ardhurave të prindërve të personit të lidhur/bashkëshortit dhe shumës e cila ka qenë dhuruar ndaj tij, ato kanë qenë të ligjshme e në përputhje me normat shoqërore.

6.52 Fakti i mosvërtetimit të pagesave të qirasë nga firma “****” për përdorimin me qira të banesës së motrës së personit të lidhur bashkëshortit nuk i bën këto të ardhura të paligjshme në kuptim të genies së tyre si burim për krijimin e pasurisë.

6.53 Të tre shumat e dhëna dhuratë personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit prej babait të tij janë burime të ligjshme të ardhurash pasi janë krijuar nga babai i personit të lidhur/bashkëshortit me veprime juridike të vlefshme dhe në përputhje me ligjin.

6.54 Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi, arrin në konkluzionin se,

6.55 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë të të ardhurave nga qiraja me subjektin “****” sh.p.k., në vlerën 13.500 euro, pasi shoqëria ka kryer aktivitet ligjor në ndërtesën ndodhur në Korçë, Bulevardi “****”, nr. ***, vetëm gjatë periudhës 13.08.2012 - 02.12.2013 (7 muaj), ndërsa deklaruar nga b/shorti i subjektit prej marsit 2012 (12 muaj).

6.56 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë për investime nga shoqëria “****” sh.p.k. në kryerjen e punimeve të brendshme arredimi për kthimin e ndërtesës në Korçë, Bulevardi “****”, nr. ***, në lokal shërbimi gjatë periudhës prill - dhjetor 2013, pasi sipas aktmarrëveshjes, qëllimi i përdorimit të banesës do të jetë përshtatja e saj në lokal shërbimi, i cili do të përdoret nga qiramarrësi, shoqëria “****” sh.p.k., në të ardhmen si i tillë; më datë 02.12.2013 shoqëria “****” sh.p.k., mbyll aktivitetin në këtë ndërtesë; gjithashtu, më datë 05.01.2014, z. P.T., ka lidhur kontratë qiraje me shoqërinë “****” sh.p.k., si qiramarrëse.

6.57 Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të rremë të të ardhurave nga qiraja me subjektin “****” sh.p.k., në shumën 2.000.000 lekë për vitin 2014, në deklarimin “Vetting” dhe në deklarimin e interesave private “Periodike Vjetore 2014”, për shkak se nuk konfirmohen nga organet tatimore që për këto të ardhura të jetë paguar tatim, me qëllim që të konsiderohen të ligjshme në përputhje me nenin D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

6.58 Të ardhura të dyshimta nga qiraja me subjektin “****” sh.p.k. në shumën 5.056.000 lekë sipas kontratave datë 05.01.2015 dhe 05.01.2016, pasi aktiviteti i shoqërisë për vitet 2015 dhe 2016 rezulton me humbje ose me fitim të pakonsiderueshëm, rezultate të cilat nuk justifikojnë shpenzimet për qira në vlerën 2.880.000 lekë/vit.

6.59 Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të rremë për të ardhura nga qiraja në shumën 2.200 euro me firmën “****”, Itali, pasi nuk konfirmohen nga organet tatimore; gjithashtu, mungon dokumentacioni justifikues ligjor për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit për tatimin në burim.

6.60 Deklarim i rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për të ardhurat/dhuratë nga prindërit në shumën totale 4.026.000 lekë, pasi nuk konfirmohen nga institucionet përgjegjëse.

6.61 Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të marrë dëshmi nga z.Z.Sh. (pronar is firmës *** sh.p.k dhe ***) dhe Znj. V.Sh. (administratore e frimës *** sh.p.k), komisioni refuzon kërkesën e subjektit pasi marrja e kësaj prove duket se është e panevojshme dhe me këtë dëshmi pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili dhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.

7. Denoncim mbi pasuri të fshehura në emrin e subjektit të rivlerësimit

7.1. Neni 53 i ligjit nr. 84/2016, përcakton se: *“çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të*

informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim”.

7.2. Referuar në sa më lart, pranë Komisionit, është regjistruar një denoncim anonim, duke denoncuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar disa pasuri që i përkasin asaj, si më poshtë:

- i. Apartament në Tiranë, tek ish-ekspozita, Bulvevardi “****”, Pallati ***, përballë restorant ***, në emër të motrës së subjektit znj. Ç.P.;
- ii. Apartament në Tiranë mbrapa 15-katëshit, në emër të burrit të motrës së subjektit, znj.Ç.P.;
- iii. Apartament në Tiranë përballë Fakultetit të Drejtësisë, në emër të babait të subjektit, z. V.P.;
- iv. Apartament në Tiranë mbrapa *** (mbrapa ****), nuk dihet në emër të kujt është vënë.

7.3. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, neni 53, kreu hetim kryesisht duke kërkuar informacion pranë organeve shtetërore dhe private në lidhje me personat e përmendur në denoncim bazuar në indicet e ardhura nga ky denoncim. Nga dokumentacioni i administruar u konstatua se:

7.4. Nga hetimi rezultoi se këto persona janë të deklaruar dhe konfirmuar në pozicionin e huamarrësit dhe dhënësit nga subjekti të rivlerësimit. Gjithashtu, z.P.K./bashkshorti i motrës së subjektit ka përfaqësuar babin e subjektit të rivlerësimit/z.V.P. në blerjen e banesës prej 40 000 Euro në vitin 2010.

7.5. Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti dhe të administruar nga ana e Komisionit, shkresa nr. *** prot., datë 19.06.2018, dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer transaksione bankare në vitin 2014, 2015 me motrën e saj znj. Ç.P.

7.6. Gjithashtu nga hetimi konstatohet se në vitin 2015 subjekti ka kaluar në mënyre progresive shumë prej 550.000 lekësh, ndërsa në vitin 2014 shumë prej 900.000 lekësh. Në lidhje me transaksionet e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe konfirmuar në deklaratën vjetore të po këtij viti se i ka dhënë hua motrës së saj shumë prej 550.000 lekësh.

7.7. Në lidhje me babin e subjekti të rivlerësimit, konstatohet se subjekti ka marrëdhënie me lidhje interesi që rrjedh nga një marrëdhënie interesi pasuror, shitja e shtëpisë në Korçë ku subjekti ka 1/3 pjesë, si dhe huaja që babai i subjektit ka dhënë në vitin 2003, në shumë 1.000 000 lekë për shtimin e vlerës së aksioneve në shoqërinë “****”, e konfirmuar nga subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit

7.8. Në lidhje me denoncimin se motra e subjektit të rivlerësimit, znj. Ç.P., ka në pronësi një apartament në Tiranë tek ish-ekspozita, Bulvevardi “****”, Pallati ***, përballë restorant ***, por që i përket subjekti të rivlerësimit, Komisioni, hetoi dhe konstatoi se në emër të motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ç.P., figuron e regjistruar një pasuri me nr. ***, ZK ***, garazh me sipërfaqe 19 m², blerë në shumë 5.700 euro, në vitin 2012 dhe, një pasuri nr. ***, ZK ***, apartament me sipërfaqe 120 m², blerë në shumë 48.000 euro, në vitin 2012.

7.9. Pas verifikimi të dokumentacionit rezultoi se si adresa e pasurisë në pronësi të motrës së subjekti të rivlerësimit, znj.Ç.P., dhe emri i pronarit përputhen me të dhënat e

denoncimit. Pra, kjo pronë ndodhet tek zona e ish-ekspozitës, Bulvevardi “ ***”, Pallati ***, përballë restorant *** dhe është në emër të znj. Ç.P., motrës së subjekti të rivlerësimit.

7.10. Komisioni gjithashtu hetoi në lidhje me mundësitë financiare të ligjshme të motrës së subjekti të rivlerësimit për të blerë këto pasuri në shumë 53.700 euro, dhe pas hetimit arriti në përfundimin se ajo nuk kishte mundësi financiare për të blerës këto prona në shumë 53.700 euro, në vitin 2012.

7.11. Në lidhje me denoncimin së bashkëshorti i motrës së subjekti të rivlerësimit ka të regjistruar një apartament në Tiranë mbrapa 15-katëshit, por që sipas denoncuesit i përket subjekti të rivlerësimit, Komisioni hetoi dhe konstatoi se bashkëshorti i motrës së subjekti quhet P.K.

7.12. Në emër të bashkëshortit të motrës së subjekti të rivlerësimit, z. P.K., respektivisht figuron e regjistruar pasuria nr. ***, ZK ***, apartament me sipërfaqe 117 m², blerë në shumën 11.726.000 lekë, në vitin 2014 ; Pasuria nr. ***, ZK ***, apartament me sipërfaqe 60.25 m², blerë në shumën 6.025.000 lekë, në vitin 2014 dhe pasuria nr. ***, ZK ***, garazh me sipërfaqe 25.14 m², blerë në shumën 1.759.800 lekë, në vitin 2014.

7.13. Pas verifikimi të dokumentacionit rezulton se si adresa e pasurive në pronësi të bashkëshortit të motrës së subjekti të rivlerësimit, znj. Ç.P., dhe emri i pronarit përputhen me të dhënat e denoncimit. Pra, kjo pronë ndodhet mbrapa hotel 15-katëshit në Tiranë dhe është në emër të bashkëshortit të motrës së subjekti të rivlerësimit znj.Ç.P.

7.14. Komisioni gjithashtu hetoi në lidhje me mundësitë financiare të ligjshme të bashkëshortit të motrës së subjekti të rivlerësimit për të blerë këto pasuri në shumë 53.700 euro, dhe pas hetimit arriti në përfundimin se ai nuk kishte mundësi financiare nga burime të ligjshme për të blerë këto prona në shumë 19.510.800 lekë, në vitin 2014.

7.15. Në lidhje me denoncimin se babai i subjekti të rivlerësimit ka të regjistruar një apartament në Tiranë përballë Fakultetit të Drejtësisë, por që sipas denoncuesit i përket subjekti të rivlerësimit, Komisioni hetoi dhe konstatoi se në emër të babait të subjekti të rivlerësimit, z. V.P., respektivisht figuron e regjistruar pasuria nr. ***, ZK ***, apartament me sipërfaqe 67.7 m², blerë në shumën 40.000 euro, në vitin 2010.

7.16. Pas verifikimi të dokumentacionit rezulton se si adresa e pasurisë në pronësi të babait të subjekti të rivlerësimit, z. V.P., dhe emri i pronarit përputhen me të dhënat e denoncimit. Pra, kjo pronë ndodhet përballë Fakultetit të Drejtësisë dhe është në emër të z. V.P. , babait të subjekti të rivlerësimit.

7.17. Komisioni gjithashtu hetoi në lidhje me mundësitë financiare të ligjshme të babait të subjekti të rivlerësimit për të blerë këtë pasuri në shumën 40.000 euro, dhe pas hetimit arriti në përfundimin se ai dhe bashkëshortja e tij nuk kishin mundësi financiare për të blerës këtë pronë në shumën 40.000 euro, në vitin 2010.

7.18. **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se motra dhe babai i saj nuk duhet të konsiderohen si persona të lidhur me subjektin në kuptim të ligjit që i detyron ata të deklarojnë, por në kuadër të transparencës dhe bashkëpunimit me Komisionin, subjekti jep shpjegime në lidhje me pasuritë sipas atyre fakteve dhe rrethanave që janë parashtruar nga motra dhe babai i saj dhe atyre që ka pasur ajo dijeni gjatë viteve për shkak të lidhjes familjare që kanë.**

7.19. Gjatë gjithë periudhës kohore nga shtator 1997 dhe deri tani, motra e subjektit ka qenë gjithmonë në marrëdhënie pune, dhe për këtë ka paraqitur një tabelë me të ardhurat e motrës.

7.20. Bashkëshorti i motrës së subjektit, z. P.Th.K., ka qenë gjithmonë në marrëdhënie pune, dhe për këtë ka paraqitur një tabelë me të ardhurat e bashkëshortit të motrës.

7.1 Gjatë jetës së tyre bashkëshortore motra dhe bashkëshorti i motrës së subjektit kanë kryer disa investime në pasuritë e paluajtshme (apartamente banimi) si dhe makina. Për të kryer këto investime, përveç të ardhurave shumë të mira që kanë pasur ndër vite, ata kanë marrë dy kredi në shumën 25.000 USD dhe 16.000 euro në “Tirana Bank”. Gjithashtu ata janë ndihmuar në investimet e kryera edhe nga prindërit e bashkëshortit të motrës së subjektit, veçanërisht babai i tij Th.P.K.

7.2 Th.P.K. ka qenë në punë si inxhinier naftë në shoqërinë “****” deri në vitin 1996 dhe nga ky vit dhe deri në 2015 ka punuar si inxhinier naftë dhe me pas si konsulent pranë kompanisë “****”. Të ardhurat e tij të përbëra nga pagat e realizuara nga puna dhe shpërblimet e kompanisë, kanë qenë shumë të larta (4000 - 5000 usd/muaj), gjë që i ka mundësuar atij të mbështesë nga ana financiare.

7.3 Në analizë të të ardhurave të realizuara nga motra dhe bashkëshorti të subjektit të rivlerësimit si dhe të shpenzimeve të kryera rezulton se investimet e tyre në pasuri të paluajtshme, shpenzimet e jetesës dhe çdo shpenzim tjetër i pasqyruar në tabelë janë të justifikuar me burime të ligjshme të ardhurash, të krijuara nga të ardhurat e pagave, shpërblime, dieta, dhurata nga prindërit dhe hua të marra në bankë.

7.4 Për sa i përket të ardhurave të prindërve të subjektit, ajo shpjegoi se prindërit e saj kanë qenë në marrëdhënie pune prej shume vitesh pa ndërprerje deri sa mbushen moshën e pensionit të pleqërisë. Gjatë gjithë këtyre viteve kanë realizuar të ardhura relativisht të mira për kohën duke kursyer dhe shuma të ndryshme lekësh. Babai i subjektit të rivlerësimit/z.V.P., në periudhën 1974 -1980, ka punuar si shofer në parkun e eksportit në durrës dhe nga kjo periudhë në vitet 1990 pas ndryshimit të sistemit zotëronte një shumë rreth 2.000 USD.

7.5 Në vitin 1993 ai ka filluar punë si shofer me kamion trajler për eksport-import mallrash nga Shqipëria në Greqi dhe anasjelltas duke u paguar me page për rrugë të kryer e cila në ato vite ka qenë 25.000 dhrahmi greke. Prej tij bëheshin 3 ose 4 rrugë në javë dhe punohej me të njëjtin rritem gjatë gjithë vitit.

7.6 Duke pasur të ardhura të larta për kohën, në vitin 1995 një pjesë të tyre babai i subjektit të rivlerësimit i ka dhënë hua me përqindje tek shtetasi V.B., i cili ishte vëllai i shokut të tij G.B., person i cili në ato vite ushtronte aktivitet tregtar dhe këmbimi valutë në Shqipëri e Greqi. Nga një pjesë e dokumentacionit që zotëron babai i subjektit dhe trashëgimtarët e z V.B. si dhe nga shpjegimet që i dha babai pas pyetjes nga subjekti për efekt të këtyre shpjegimeve, shuma e dhënë hua ka qenë 6.5 milion dhrahmi dhe interesat e përfituara prej saj kanë qenë rreth 5.000.000 dhrahmi për një periudhë kohe deri në vitin 1998 kur shuma e dhënë i është kthyer nga huamarrësi.

7.7 Faktet e mësipërme dhe ekzistencën e kontratës se huas të lidhur mes këtyre personave e konfirmon edhe bashkëshortja e shtetasit V.B., znj P.B. banuese në Korçë.

7.8 Si provë subjekti ka bashkëlidhur:

- 4 fotokopje të pasaportave të babait i subjektit të rivlerësimit ku pasqyrohen lëvizjet e tij shumë të shpeshta në Greqi;
- vërtetim të periudhave dhe vendeve ku ka punuar para viteve 1990, të ardhurat e realizuara nga nëna ime gjatë periudhës së saj në punë;
- shkresa dore të thjeshta të lëshuara nga babait i subjektit të rivlerësimit dhe shtetasi V.B. mbi detyrimet mes tyre dhe shlyerjet e tyre të cilat në bazë të nenit 83/2 e 1050 e vijues të Kodit Civil përbëjnë provë të ekzistencës së kontratës së huas mes palëve të pasqyruara në to.

7.9 Nga këto shuma të dhëna hua prindërit e mi kanë shtuar të ardhurat e tyre, kanë shpenzuar për jetesën familjare dhe kanë investuar në një banesë të ndodhur në Korçë, Rr. “***” dhe pjesërisht në një banesë në Tiranë, në bono thesari dhe në tokë arrë të ndodhur në fshatin Dishnicë, Korçë.

7.10 Në lidhje me konstatimin e Komisionit për banesën në pronësi të babait i subjektit të rivlerësimit /V.P. në Tiranë sqarohet se ajo është blerë nga prindërit dhe motra e subjektit të rivlerësimit/Ç.P. në vitin 2010, për të mundësuar jetesën e tyre në Tiranë me qëllim dhënien e ndihmës motrës në rritjen dhe kujdesin e fëmijëve të saj në kushtet kur si motra dhe bashkëshorti ishin në punë. Sipas sqarimeve të tyre pagesa prej 40.000 eurosh, për blerjen e saj është përballuar në masën 2.500.000 lekë nga motra dhe pjesa tjetër nga prindërit me kursimet e tyre ndër vite.

7.11 Do i kërkoja Komisionit që në vlerësim të shpjegimeve të dhëna sa më sipër dhe në rast të plotësimit të tyre me të dhëna të tjera, të thërriste si dëshmitare motrën e subjektit të rivlerësimit/z. Ç.P.

7.12 Komisioni pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi në lidhje me të gjitha rrethanat e faktit, arrin në konkluzionin se ka dyshime të arsyeshme se këto pasuri që janë regjistruar në emër të motrës së subjektit, znj. Ç.P., bashkëshortit të motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. P.K. dhe babait të subjektit, z. V.P., të jenë pasuri të krijuara nga ana e subjektit të rivlerësimit për shkak se:

- i. Të dhënat mbi adresat dhe pronarët e këtyre pronave (motrës, bashkëshortit të motrës dhe babait të subjektit) sipas ZRPP-së Tiranë përputhen me të dhënat e denoncimit anonim të depozituar pranë Komisionit.
- ii. Nga analizimi i të ardhurave të ligjshme të motrës, bashkëshortit të motrës dhe babait të subjektit të rivlerësimit, rezulton se ato nuk kanë mjaftueshëm të ardhura nga burime të ligjshme për të krijuar këto pasuri.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrëdhëniet e interesit me motrën dhe bashkëshortin e saj nëpërmjet huas së dhënë, pagesave periodike të kryera në vitin 2014, duke u shprehur se e ka ndihmuar financiarisht (në përgjigje të pyetësorit), por nga ana tjetër subjekti deklaroi se motra ka mundësi të blejë vetë pronë dhe për më shumë në vitin 2010 të ndihmojë dhe babin e saj z. V.P. me 2.500.000 lekë për të blerë apartament.

- iv. Subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrëdhënien e interesit me babin e saj, pasi prindërit në vitin 2003 i kanë dhënë borxh shumë prej 1.000.000 lekësh bashkëshortit të subjektit, për të blerë kuota në shoqërinë “****” sh.p.k në vitin 2003.
- v. Nga dokumentacioni justifikues që subjekti ka sjellë për të vërtetuar të ardhurat e motrës dhe bashkëshortit të saj si dhe të ardhurat e prindërve të saj, del qartë rezultati se të ardhurat e tyre nuk ishin të mjaftueshme për të krijuar pasuri, sipas viteve respektivë.

7.13 Bazuar në të gjitha indicet dhe rrethanat e çështjes, Komisioni, arrin në përfundimin se ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të forta se subjekti i rivlerësimit mund të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme dhe subjekti është përpjekur të fshehtë pasuritë të cilat figurojnë të regjistruara në emër të motrës znj. Ç.P., në emër të bashkëshortit të motrës P.K. dhe në emër të babait të saj V.P., për arsye se ajo nuk arriti të vërtetojë të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me denoncimin e ardhura.

7.14 Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të marrë dëshmi nga motra e subjektit të rivlerësimit/znj. C.P., komisioni refuzon kërkesën e subjektit pasi marrja e kësaj prove duket se është e panevojshme dhe me këtë dëshmi pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili dhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.

VI. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit e pasurisë, denoncimit nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 si dhe vlerësimin tërësor të procedurave në lidhje me kriterin pasuror, Komisioni arrin në përfundimin se:

a. Për vlerësimin e pasurisë, Komisioni gjykon se:

- 1. Për pasurinë nr. ***, apartament banimi, me sipërfaqe 55 m², ZK ***, Nr. pasurie ***, Rr. “****”, Korçë, subjekti i rivlerësimit:**
 - i. nuk arriti të provojë të kundërtën e faktit të konstatuar se ka fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pronësinë e këtij apartamenti;
 - ii. ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, për shkak se ka mungesë të burimeve financiare shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues për blerjen e këtij apartamenti;
 - iii. ka fshehje të pasurisë nga ana e personit të lidhur/bashkëshortit;
 - iv. ka deklaram të rremë në lidhje me burimin që ka shërbyet për blerjen e këtij apartamenti.
- 2. Për të ardhurat e deklaruara nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me prindërit, në shumën prej 1.000.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit:**
 - i. nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues diferencën në shumën 1.150.000 lekë të çmimit të shitjes sipas kontratës së shitjes (është në shumën 1.950.000 lekë) me çmimin e deklaruar në deklaratën “Vetting” (3.100.000 lekë);
 - ii. ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, për shkak se ka mungesë të burimeve financiare në shumën prej 35.000 lekësh shoqëruar me

- dokumentacion ligjor justifikues për pjesën takuese përfituar nga shitja e apartamentit të prindërve;
- iii. ka deklarim të rremë në lidhje me shumë e shitjes së këtij apartamenti.
3. **Të ardhurat në nga shitja e automjeteve, tip “Renault”, në vlerën prej 450.000 lekësh dhe tip “Benz Daimlerchrysler” në vlerën 6.000 euro, subjekti i rivlerësimit** ka kryer deklarim të rremë në lidhje me çmimin e shitjes së këtyre automjeteve, për shkak se ka fshehur çmimin real të shitjes së këtyre automjeteve.
4. **Për apartamentin e banimit *dublex* me sipërfaqe 235 m², ZK ***, me nr. pasurie ***, Rr. “****”, Korçë, subjekti i rivlerësimit, në lidhje vërtetësinë e deklarimeve**
- i. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë në lidhje me deklarin se ka bërë investim personal për përfundimin e rifiniturave me firmën “****”, në shumën 1.316.300 lekë, për shkak se nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues punimet e kryera për përfundimin e rifinituarve nga firma “****”, si dhe nuk provoi me anë të një dokumenti ligjor provues pagesën që i ka kryer shoqërisë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur çmimin real të paguar për blerjen e apartamentit të banimit *dublex* 235 m², të papërfunduar, karabina, në shumën prej 2.000.000 lekësh, për shkak se nuk arriti të provojë bindshëm me dokumentacion ligjor provues se kjo vlerë është vlera reale që personi i lidhur ka paguar krahasuar me koston mestare të ndërtimit sipas EKB-së e cila është 5.943.385 lekë.

Në lidhje me burimin e ligjshëm

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie dhe ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie;
- ii. subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj nuk paraqitën dokumente që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtij apartamenti banimi *dublex*, investuar 4.000.000 lekë nga viti 2001 deri në vitin 2004, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 1 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me këtë aset, për shkak se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar investimin në blerjen dhe ndërtimin e rifinituarve në shumë 4.000.000 lekë nga viti 2001 deri në vitin 2004.
5. **Për banesën me sipërfaqe 198 m², “****” ZK ***, nr. pasurie ***, ndodhur në, Bulevardi “****”, Korçë, subjekti i rivlerësimit:**
- i. Në lidhje me sipërfaqen e banesës - ka fshehur sipërfaqen reale të godinës në deklarin “Vetting” 2017, duke mos e deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë e personit të lidhur me të dhe referuar **nenit D të Aneksit të Kushtetutës**, pika 5, “*nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën*”.
- ii. **Në lidhje me dhurimin si mënyrë e fitimit të ½ pjesë të godinës** - personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit/bashkëshorti ka bërë deklarim të rremë në lidhje me dhurimin e ½ pjesë të kësaj ndërtese dhe ka nënshkruar një kontratë fiktive.
- iii. **Në lidhje me blerjen si mënyrë e fitimit të ½ pjesë të godinës** - Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm që çmimi i shitjes së makinës në vlerën 6.000 euro ishte real/i vërtetë dhe për më shumë nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues riparimin

- e mjetit nga babai i saj. Më tej, subjekti i rivlerësimit rezultoi se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e blerë në shumën 4.000.000 lekë.
- iv. **Në lidhje me vlerësimin e çmimit të godinës për efekt të blerjes së ½ pjesë në shumën 4.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit** ka fshehur vlerën reale të blerjes së kësaj banese për shkak se gjatë hetimit u vërtetuar se vlera e tregut në vitin 2008 ka qenë rreth 10.397.313 lekë, ndërsa subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor se pse blerja ishte nën vlerën e çmimit të tregut.
 - v. **Në lidhje me vlerën e punimeve për rikonstruksionin e godinës dhe kthimin e saj në identitet subjekti i rivlerësimit** ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk arriti të provojë pagesën e kryer shoqërisë “****” për punimet e kryera në lidhje me rikonstruksionin e godinës private Bulevard “****”, në muajin shkurt 2012, në shumë 6.979.400 lekë. Për sa rezulton, nuk u provua shuma e paguar, lloji i punimeve si dhe koha e kryerjes së punimeve të rikonstruksionit. Më tej, subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi dhe provoi bindshëm se kjo ishte vlera e paguar për rikonstruksionin e godinës, duke fshehur investimin real për rikonstruksionin e kësaj godine.
 - vi. **Në lidhje me shpenzimet për arredimin dhe kthimin e godinës në lokal shërbimi,** subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë pasuri pasi ka bërë deklaram të rremë dhe ka fshehur vlerën e arredimit luksoz të godinës me një kat përdhes e përdorur si piceri, kati i parë përdorur si bar- kafe, kati i dytë i përdorur si restorant, kati i tretë i përdorur si verandë, e gjithë kjo me qëllim që të fshehë burimin e ligjshëm financiar për këtë investim.
 - vii. **Në lidhje me deklaramin e ambientit, verandë, subjekti i rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit** ka fshehur ndryshimin e destinacionit të çatisë, në verandë me qëllim përdorimin për bar-kafe, në deklaramin “Vetting” dhe në deklaramet vjetore dhe ka kryer deklaram të rremë dhe kanë fshehur verandën e krijuar në çatinë e godinës dhe destinacionin e saj në deklaramin “Vetting” 2017 dhe deklaramet periodike vjetore, me qëllim që të fshehë burimin e ligjshëm që ka shërbyer si investim për këtë ndryshim.
- 6. Për njësinë me sipërfaqe 519 m², ZK ***, nr. pasurie ***, ndodhur në Korçë, godina ****, në pronësi të bashkëshortit, z. P.T.:**
- i. **Në lidhje me vlerën e shkëmbimit të aksioneve,** subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë fshehur vlerën reale të pasurisë “njësi” me sip. 519 m², në godinën ****, Korçë, me qëllim fshehjen e burimit të ligjshëm financiar për krijimin e saj.
 - ii. **Në lidhje me burimin e ligjshëm të blerjes së aksioneve prej 8 % në shoqërinë **** sh.p.k.,** subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, për shkak se ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor për marrjen dhe shlyerjen e huas prej 5.000.000 lekësh, që ka shërbyer si burim për blerjen e 8 % të kuotave të shoqërisë **** sh.a. dhe ka bërë deklaram të rremë në lidhje me shlyerjen e huas ndaj shtetasit A.B.
 - iii. **Në lidhje me pjesëmarrjen si aksioner me 8 % të kuotave në shoqërinë **** sh.a të personit të lidhur,** subjekti i rivlerësimit ka fshehur pjesën takuese të fitimit në shoqërinë **** sh.a, në deklaramet periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI-së, si dhe rritjen e vlerës së aksioneve si rrjedhim i rritjes së kapitalit në shumë 6.000.000 lekë në vitin 2003; shumë 9.119.120 lekë në vitin 2007 dhe shumë 14.274.880 lekë në vitin 2009. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shkëmbimin e 8% të kuotave (në vlerë 6.496.000 lekë), me njësinë me sipërfaqe 519 m², ndodhur në godinën ****, Korçë.
- 7. Për pasuri të pa deklaruara në deklaramin “Vetting” të vitit 2017 dhe/ose Deklarama Vjetore pranë ILDKPKI-së, të konstatuara nga hetimit administrativ:**

- i. Subjekti i rivlerësimit, ka fshehur depozitim e shumë prej 2.000.000 lekësh në llogarinë e personit të lidhur bashkëshortit, në deklarin vjetor të vitit 2008.
- ii. Subjekti i rivlerësimit, ka fshehur kreditimin e shumë prej 70.000 eurosh në llogarinë e personit të lidhur/bashkëshortit nga “Alpha Bank” në deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2008”. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin dhe ligjshmërinë e kësaj shume të depozituar në llogarinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues financiar për të krijuar depozitën në shumën prej 70.000 USD nga “Alpha Bank”.
- iii. Subjekti i rivlerësimit, ka fshehur depozitën prej 10.023 eurosh në deklaratën e interesave private “Deklarimi për herë të parë” të vitit 2003; nuk ka deklaruar destinacionin/pakësimin e kësaj shume në deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2004” dhe nga analiza financiare e të ardhurave, pasurive dhe detyrimeve të vitit 2003, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare me dokumentacion ligjor provues për të justifikuar depozitën në shumën prej 10.023 euro, pranë “Credins Bank”.
- iv. Subjekti i rivlerësimit, nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues të kësaj shume dhe rezulton me mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor për të provuar shumë prej 3.600.000 lekësh si dhe ka fshehur në deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2007” shumën prej 3.600.000 lekësh.
- v. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditetet bankare në emër të bashkëshortit të saj/P.T., në shumën totale 4.006.722 lekë, datë 31.12.2004, në deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2004” dhe ka mungesë e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj shume.
- vi. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar destinacionin e përdorimit të shumave 2.351.302 lekë, në deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2005” dhe 1.882.855 lekë, në deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2006”.
- vii. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar depozitën në emër të djalit, E.T. në deklaratat e interesave private “Periodike Vjetore” 2006 - 2009, me gjendje 1.406.000 lekë, datë 31.12.2006; 1.462.235 lekë, datë 31.12.2007; 1.818.763 lekë, datë 31.12.2008; 2.047.000 lekë, datë 31.12.2009.
- viii. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar depozitën në emër të vajzës, E.-M.T., në deklaratat e interesave private “Periodike Vjetore” 2006 - 2009, me gjendje 360.000 lekë, datë 31.12.2006; 521.469 lekë, datë 31.12.2007; 650.545 lekë, datë 31.12.2008; 804.000 lekë, datë 31.12.2009.

8. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. P.T.:

- i. subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklarin të rremë të të ardhurave nga qiraja me subjektin “***” sh.p.k, në vlerën 13.500 euro.
- ii. Subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklarin të rremë për investime nga shoqëria “***” sh.p.k, në kryerjen e punimeve të brendshme arredimi për kthimin e ndërtesës të ndodhur në, Bulevardin “***”, nr. *** Korçë, në lokal shërbimi gjatë periudhës prill - dhjetor 2013.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të rremë të të ardhurave nga qiraja me subjektin “***” sh.p.k, në shumën 2.000.000 lekë për vitin 2014, në deklarin “Vetting” dhe në deklarin e interesave private “Periodike Vjetore 2014”.
- iv. Të ardhurat nga qiraja me subjektin “***” sh.p.k, në shumën 5.056.000 lekë sipas kontratave datë 05.01.2015 dhe 05.01.2016, nuk janë bindëse.

- v. Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të rremë për të ardhura nga qiraja në shumën 2.200 euro me firmën “***”, Itali.
- vi. Deklarim i rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për të ardhurat/dhuratë nga prindërit në shumën totale 4.026.000 lekë.

9. Lidhur me denoncimin mbi pasuri të fshehura në emrin e subjektit të rivlerësimit, bazuar në të gjitha indicet dhe rrethanat e çështjes, Komisioni arrin në përfundimin se ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të forta se subjekti i rivlerësimit mund të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme dhe subjekti është përpjekur të fshehtë pasuritë të cilat figurojnë të regjistruara në emër të motrës, znj. Ç.P., në emër të bashkëshortit të motrës, z. P.K. dhe në emër të babait të saj, z. V.P., për arsye se ajo nuk arriti të vërtetojë të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me denoncimin e ardhur.

b. Për vlerësimin tërësor në lidhje me kriterin e pasurisë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit:

- i. nuk arriti të provojë bindshëm fshehjet e deklarimeve të depozitave, llogarive bankare dhe likuiditeteve të ndryshme në deklarata periodike vjetore të interesave privatë pranë ILDKPKI-së
- ii. nuk arriti të justifikojë me dokumentacion ligjor provues shumë nga pasuritë e mosdeklaruara ndër vite.
- iii. nuk arriti të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur (motrës, babait dhe bashkëshortit të motrës), për blerjen e pasurive të denoncuara nga publiku dhe të konstatuara nga hetimi i Komisionit
- iv. nuk arriti një nivel të besueshëm në lidhje me vlerësimin e pasurisë
- v. me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj në lidhje me vlerësimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

Në këto kushte, Komisioni bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi si dhe bindjen e brendshme vendosi që subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni D, Ç dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar si dhe neni 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 10.10.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Firdes SHULI

Kryesuese

Roland ILIA

Anëtar

Etleđa ÇIFTJA

Relatore

Olsida GOXHAI

Sekretare gjyqësore